

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00 Nr.12/2024	Data: 31.01.2024	

Kuvendi i Komunës në baze të nenit 40 paragrafi 40.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) dhe nenit 33 paragrafi 33.1 pika 4 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010, në mbledhjen e mbajtur me 31.01.2024 Shqyrtoj Raportin e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2023, dhe nxjerri këtë:

NJOFTIMIN ME RAPORTIN E PUNË SË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2023

1. Kuvendi i Komunës shqyrtojë Raportin e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2023.
2. Raporti është pjesë përbërës e këtij njoftimi.
3. Me kopje të këtij Njoftimi të njoftohen: Kryetari i Komunës dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendi.

	REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E ISTOGUT - OPŠTINA ISTOK DREKTORATI PËR ADMINISTRATË - DIREKCIJA UPRAVE	
11		
Nr./Br. <u>00-039-18</u> Nr. i faq/Br.str. <u>01</u>		
Data/Datum <u>07 / 02 / 2024</u> ISTOG • ISTOK		

Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova





REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E ISTOGUT/ OPSTINA ISTOK/ MUNICIPALITY OF ISTOG

KRYETARI/PREDSIEDNIK/MAYOR

R A P O R T

I PUNËS SË KRYETARIT PËR PERIUDHËN
JANAR- DHJETOR 2023

Janar 2024

PËRMBAJTJA:

1. HYRJE	3-7
2. DREJTORIA PËR ADMINISTRATË KOMUNALE.....	7-19
3. DREJTORIA PËR INSPEKSION.....	19-22
4. DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA.....	22-29
5. DREJTORIA PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM.....	29-32
6. DREJTORIA PËR KADASTËR, PRONË DHE GJEODEZI.....	33-33
7. DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS.....	34-40
8. DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT.....	40-45
9. DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT.....	46-48
10. DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE HIDROEKONOMI.....	48-53
11. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI	53-55
12. DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPETIM.....	55-61
13. DREJTORIA PËR PUNË DHE MIRËQENIE SOCIALE.....	61-62
14. DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE.....	63-65
15. ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE.....	65-67

HYRJE

Udhëheqësi i Komunës

Komuna, si njësi themelore e pushtetit lokal, funksionon në bazë të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/08), Statutit të Komunës si akti më i lartë i komunës, si dhe Ligjeve të tjera me të cilat janë përcaktuar kompetencat dhe fusha e veprimtarisë së saj. Me ligjin e përmendur janë përcaktuar struktura dhe organet e pushtetit lokal, ndërsa Komunave u është lënë hapësirë për formimin e drejtorive, respektivisht përcaktimin e numrit të tyre. Në këtë kontekst, si organet e Komunës në Ligjin për vetëqeverisjen lokale janë përcaktuar: Kryetari, si organi më i lartë ekzekutiv, i zgjedhur drejtpërdrejt nga qytetarët, dhe Kuvendi Komunal, si organi më i lartë vendimmarrës.

Kryetari i Istogut, z. Ilir Ferati (LDK), është zgjedhur në zgjedhjet lokale të vitit 2021. Lidhja Demokratike e Kosovës mban 11 nga 27 ulëset në Asamblenë Komunale. Partia e dytë më e madhe, me 7 ulëse, është AAK, e përcjellur nga VV me 5 anëtarë të asamblesë, PDK me 3 anëtar dhe GIBI me një ulëse. Në kuadër të kuvendit janë themeluar dy komitete obligative: Komiteti për Politikë dhe Financa, Komiteti për Komunitete, Komiteti për barazi gjinore dhe komitete të tjera, siç parashihen me ligj. Komuna publikon procesverbalin dhe të gjitha aktet e miratuara nga takimi i Asamblesë në ueb-faqen komunale.

Komuna e Istogut është e organizuar në 13 drejtori dhe Zyra Komunale për Komunitet dhe Kthim, duke shtuar Zyrën e Kryetarit, përgjegjëse për obligimet horizontale të komunës.

KRYETARI I KOMUNËS

Kryetari është organi më i lartë ekzekutiv, i zgjedhur drejtpërdrejt nga qytetarët, i cili e përfaqëson komunën. Gjatë këtij viti, Kryetari i Komunës, në veçanti, krahas punëve dhe obligimeve të tjera, ka shqyrtuar dhe realizuar çështje të rëndësishme nga përgjegjësitë komunale duke:

- Realizuar projektet prioritare të përcaktuara nga viti i kaluar dhe ato të përcaktuara nga ky vit;
- Shqyrtuar kërkesat e ndryshme të qytetarëve;
- Organizuar dhe menaxhuar organet komunale të administratës dhe i ka kompletuar ato me profesionistë, duke angazhuar përkushtim të vazhdueshëm në organizimin dhe sistematizimin e shërbimit civil, në mënyrë që qytetarët të kenë qasje më të lehtësuar për kryerjen e shërbimeve komunale;
- Hartuar dhe propozuar rregulloret dhe vendimet e ndryshme në fushën e kompetencave komunale, të cilat kanë kaluar nëpër Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin për miratim;
- Kryer detyrat dhe punët e tjera të rregullta, të përcaktuara nga fusha e veprimtarisë dhe kompetencat e tij.

Kryetari i Komunës në periudhën Janar-Dhjetor 2023 ka nënshkruar gjithsej 34 (tridhjetë e katër) Memorandume Bashkëpunimi (MB), ndër to marrëveshje me Ministrinë e Administratës së Pushtetit Lokal, MBPZHR-në, KFOR-in, Këshillin Evropian, Fondin Kosovar për Efikasitet të Energjisë, Organizata Joqeveritare (OJQ), etj. Në kuadër të Zyrës së Kryetarit funksionojnë edhe: Zyra e Integriteteve Evropiane, Zyra Ligjore, Zyra e Komunikimit dhe Informimit, Zyra e Menaxherit të Personelit, Avokati Publik dhe Auditori i Brendshëm. Në kuadër të Zyres së Integriteteve Evropiane dhe Zyres Ligjore hartohen planet operative për përmbushjen e prioriteteve për integritete evropiane, ofrohen këshillime dhe mendime profesionale juridike, ofrimi i ndihmës dhe hartimi i projekt-rregulloreve komunale, etj. Në kuadër të Zyres së Informimit në mënyrë të rregullt ofrohen informata për opinionin dhe mediat elektronike dhe ato të shkruara për të gjitha aktivitetet e Kryetarit, Drejtorateve, dhe punën në përgjithësi të organeve komunale të administratës, si dhe bëhet azhurnimi dhe mirëmbajtja e ueb faqes së komunës.

Gjatë periudhës njëvjeçare nga janari deri në dhjetor 2023, janë realizuar 19 procedura rekrutimi të pranimit (konkurse të jashtme) në Administratën Komunale, të cilat kanë rezultuar me sukses për kandidatët e përzgjedhur.

Avokati publik, në pajtim me ligjet pozitive në fuqi, mbron interesat e Komunës pranë gjykatave kompetente.

Gjatë kësaj periudhe të qeverisjes, është bërë një punë e madhe në aspektet e propozimeve dhe realizimeve të projekteve kapitale të rëndësishme për komunën tonë. Janë identifikuar prioritetet e tjera, dhe është vazhduar me prioritetet të cilat janë realizuar dhe do të paraqiten në vijim në kuadër të raportimeve të drejtorateve përkatëse. Krahas synimeve të cekura më lartë, Kryetari ka kryer edhe punë të tjera, duke përfshirë kontaktimin me organizata të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare, përfaqësues të OSBE-së, EULEX-it, ICO-së, KFOR-it dhe vizita të ndryshme të niveleve ndërkombëtare, qeveritare, komunale, që i ka bërë Kryetari dhe që i janë bërë komunës sonë në këtë periudhë njëvjeçare.

SEKTORI LIGJOR

RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-DHJETOR 2023

Nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023, Zyra Ligjore ka kryer punët si vijon:

- Vendime: Tetëqind e tetëdhjetë e pesë (885);
- Kontrata: Njëqind e pesëdhjetë e dy (152);
- Marrëveshje: Njëzet e një (21);
- Shkresa të ndryshme: Njëqind e tridhjetë e pesë (135);
- Autorizime: Gjashtëmbëdhjetë (16);
- Propozim-vendime: Katërmëdhjetë (14);
- Njoftime për dëgjime me qytetar: Pesë (5);
- Lëndë për shqyrtimin e të drejtës banesore: Shtatëdhjetë e tetë lëndë (78) në Drejtorinë për Planifikim Urban dhe Mjedis;
- Ankesa: Tri (3) në Drejtorinë për Planifikim Urban dhe Mjedis;
- Ankesa të tatimit në pronë: Gjashtëmbëdhjetë (16);
- Kërkesa për korrigjime të tatimit në pronë: Dy (2).

Sektori Ligjor ka punuar në Grupe punuese për hartimin e rregulloreve të ndryshme komunale; për hartimin e Planeve të Veprimit; hartimin e Strategjive të ndryshme; pjesëmarrje në hartimin e Statutit të Mirëqenie Sociale; Puna në Komisione të ndryshme; Puna për mbledhjen e të dhenave në fushën e legjislacionit gjatë vitit 2023 për performancën komunale; Përgatitja dhe marrja pjesë në mbledhjet e Kuvendit të Komunës; mbledhjen e Komitetit për Politik dhe Financa; Bashkëpunimi-konsultimi me Drejtoret e Drejtorive si dhe zyrtaret komunal lidhur me zbatimin e legjislacionit; Punimi i raporteve të ndryshme; Futja në sistem elektronik e të gjitha lëndëve të kryera; Pjesëmarrja në trajnime të ndryshme; në tryeza të rrumbullakta; në konferenca; si dhe janë kryer edhe shumë punë tjera të dhënë nga mbikëqyrësi.

ZYRA E INTEGRIMEVE EVROPIANE RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-DHJETOR 2023

Zyra për Integrime Evropiane (ZIE) ka zyrtarin përgjegjës i cili kryen punët dhe obligimet në përputhjen me Rregulloren 08/2011 për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Zyrave Komunale për Integrim Evropian. Zyra në fjalë, mbikëqyr aktivitet e drejtorive dhe sektorëve që burojnë nga planet e Veprimit për Partneritet Evropian, obligimet e komunës që dalin nga Agjenda Evropiane 2023 e që ka të bëjë me Programin Kombëtar për zbatim të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKMSA), si dhe dokumente tjera strategjike të MAPL-së, respektivisht Qeverisë së Kosovës. Në kuadër të përgjegjësi të Zyrës për Integrime Evropiane, zyrtari përgjegjës në vazhdimësi mbikëqyr hartimin e rregulloreve komunale, për të siguruar se ato janë në përputhje me standardet evropiane si dhe hulumton programe të ndryshme të asistencës së BE-së dhe donatorëve të tjerë për të ofruar mbështetje për qeverisje të mirë dhe zhvillim lokal. Tashmë e kemi dorëzuar raportin vjetor (Janar-Dhjetor, 2023), raport që pasqyron përmbushjen e obligimeve të komunës nga fusha e Agjendës Evropiane.

ZYRA E AUDITORIT TË BRENDSHËM RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-DHJETOR 2023

Zyra e Auditorit të Brendshëm në Komunën e Istogut është e organizuar si Njësi e Auditimit të Brendshëm (NJAB), që vepron në kuadër të Zyrës së Kryetarit të komunës me një Auditor të Brendshëm. Puna e NJAB bazohet në Planin vjetor, i cili aprovohet dhe miratohet nga Kryetari i komunës dhe Komiteti i Auditimit, sipas Ligjit nr. 06/L-021 KBFP, neni 23 pika 1.2 dhe neni 25 pika 3.3.

Gjatë vitit 2023, në NJAB është finalizuar Raporti për Zyrën e Tatimit në Pronë, Raporti i Auditimit në Drejtorinë e Shëndetësisë me fushëveprim të hyrat nga participimi për shërbimet shëndetësore dhe shpenzimet e karburantit për vitin 2022-2023. Po ashtu, është në proces të finalizimit Raporti për Menaxhimin e Pasurive Jo Financiare të komunës. Raportet finale nga auditimi i brendshëm janë shqyrtuar në Komitetin e Auditimit në lidhje me gjeturat dhe rekomandimet e dhëna nga NJAB.

Arsye për moskryerjen e auditimeve sipas numrit të planifikuar të auditimit të brendshëm është se z. Riza Alihajdaraj, Udhëheqës i NJAB në Komunën e Istogut, ka shkuar në pension me datë 28.05.2023

dhe nuk ka mundur të realizojë Planin Vjetor 2023 të NJAB. Aktivitetet e Auditimit sipas Planit Vjetor 2023 të pa realizuara janë bartur në Planin Vjetor 2024 të NJAB.

ZYRA PËR KOMUNIKIM DHE INFORMIM

RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-DHJETOR 2023

Gjatë kësaj përudhe, Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun e cila funksionon në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës z. Ilir Ferati, ka vazhduar me punën e saj të përditshme, duke pasqyruar në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha informacionet e duhura që kanë të bëjnë me punën dhe aktivitetet e Komunës së Istogut.

Kjo zyrë ka lëshuar çdo ditë të punës komunikata nga më të ndryshme të cilat kanë pasqyruar punën e cila zhvillohet brenda institucionit të Komunës së Istogut.

Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun (ZIK), ka arritur që të lëshojë mbi 500 komunikata dhe komunikime të ndryshme që përmes ueb-faqes dhe faqes zyrtare të Komunës së Istogut në rrjetet sociale, kanë informuar qytetarët mbi menaxhimin si dhe aktivitetet të përditshme të komunës sonë.

Ueb-sajti i komunës sonë pavarësisht problemeve që janë paraqitur pas ridizajnit të ueb faqes komunale nga ana e MAPL-së, çdo ditë është i freskët me plasimin e të gjitha lajmeve dhe ngjarjeve në komunën tonë, përfshirë këtu paralajmërimet e ngjarjeve, përcjelljen e ngjarjeve në komunë, por edhe jashtë komunës.

Në mënyrë që Komuna e Istogut të jetë sa më efikase dhe të ketë një transparencë sa më të madhe karshi shoqërisë civile, medias dhe faktorëve të tjerë relevantë, kemi bërë raportime të rregullta edhe mbledhjet e kuvendit, procesverbalet e kuvendit, po ashtu edhe procesverbalet e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete, komitete këto që janë obligative për komunën.

Rregulloret e nxjerra nga Kuvendi i Komunës, të gjitha janë publikuar në ueb faqen e Komunës, por edhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Po ashtu vlen të theksohet se në ueb faqe, bëhen publike vazhdimisht të gjitha njoftimet dhe konkurset, ndërkohë që aty pasqyrohen edhe të gjitha vendimet e marra nga Kryetari i Komunës si dhe vendimet e drejtorive komunale. Është punuar mjaft shumë edhe në publikimin e të gjitha kontratave të Zyrës së Prokurimit, por edhe njoftimeve të ndryshme të po kësaj zyreje.

Përparësi e ueb faqes së Komunës së Istogut është edhe ajo se secili lajm, informacion, njoftim dhe konkurs bëhet përveç në gjuhën shqipe, edhe në atë të komunitetit pakicë serb.

Në ueb faqen tonë, qytetarët e interesuar, shoqëria civile dhe mediat po ashtu mund të gjejnë të publikuara edhe të gjitha pasqyrat financiare, projektet e realizuara, projektet që do të realizohen dhe gjithçka tjetër që mund të jetë në interesin e tyre.

Në kuadër të Zyrës për Informim dhe Komunikim me Publikun funksionon edhe zyrtarja për Qasje në Dokumente Publike. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor kemi pasur njëmbëdhjetë (11) kërkesë për qasje të miratuar.

Po ashtu në zyrën për Informim dhe Komunikim me Publikun funksionon edhe zyrtari për konsultime publike. Gjatë periudhës Janar – Dhjetor janë mbajtur shtatë (7) Dëgjime Buxhetore dhe shtatë (7) Konsultime Publike që gjithsej i bijnë 14 Takime Publike me Qytetarë.

Avokati publik- Punët-detyrat e punës të caktuara me programin e punës për periudhën raportuese e për të cilat është caktuar mbajtja e shqyrtimit në tërësi janë realizuar.

DREJTORIA PËR ADMINISTRATË KOMUNALE

RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-DHJETOR 2023

HYRJE

Drejtorja për Administratë Komunale është drejtorja më e madhe dhe ka si qëllim realizimin sa më të suksesshëm të përgjegjësiave. Në fillim, ka hartuar planin e punës, në të cilin janë paraqitur synimet që do të përmbushen në këtë periudhë. Administrata komunale është një segment i rëndësishëm i komunës, ku qytetarët kanë kontakte të drejtpërdrejta me pushtetin komunal në realizimin e të drejtave dhe obligimeve të tyre. Gjatë kësaj periudhe, kemi bërë përpjekje që administrata të jetë sa më funksionale dhe në pajtim me standardet bashkëkohore. Qytetarët duhet të kenë mundësinë të realizojnë të drejtat e tyre në aspektin kohor dhe cilësor, duke përfshirë përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës. Në këtë drejtim, veprimtaria kryesisht ka qenë e orientuar në realizimin e synimeve programore, respektimin dhe zbatimin e ligjit, si dhe aktet tjera të përgjithshme juridike, si parakushte për krijimin e një administrate funksionale dhe efikase. Këto orientime janë në interes të përmbushjes së kërkesave të përgjithshme dhe individuale të qytetarëve, pa dallim përkatësie nacionale, fetare, gjinore dhe racore. Orientimet e tilla, sipas planit strategjik të punës, kanë ndikuar dukshëm në ngritjen e shkallës së përgjegjësisë në punë, disiplinës në punë, avancimit të metodës së punës dhe efikasitetit në punë.

Në kontekst të kryerjes së shërbimeve, deri tani nuk kemi pasur asnjë vërejtje nga qytetarët tanë. Kjo do të thotë se, sipas vlerësimit të përgjithshëm, administrata ka përmbushur obligimet e saja në mënyrë korrekte dhe cilësore.

Në kuadër të kësaj drejtorie, për këtë periudhë raportuese janë realizuar projektet si në vijim:

1. “Blerja e automjeteve për nevoja të administratës komunale”, vlera afër 146,000.00 euro;
2. “Blerja e materialit higjienik-sanitar” (kontratë kornizë tri vjeçare), vlera 25,000.00 euro;
3. “Renovimi dhe rregullimi i arkivit të qytetit”, në shumë prej 9,600.00 euro
4. Janë funksionalizuar 5 (pesë) e-Kioska në komunën e Istogut”, ne funksion te qytetareve në Zyrat e vendit Vrellë, Banjë, Rakosh, Gjurakoc dhe ne hapësirat e oborrit te objektit të Komunës ku qytetarët mund ti tërheqin 5 dokumente te Gjendjes Civile 24/7;

5. "Mirëmbajtja e e-kioskave" (kontratë kornizë tri vjeçare), vlera 3,300.00 euro;
6. "Infrastruktura për "smart city"", (kontratë tri vjeçare) vlera për këtë vit 42,000.00 euro;
7. "Renovimi i nyjave sanitar në objektin e komunës", vlera 1,000.00 euro;
8. "Mirëmbajtja e higjenik-sanitare objekteve komunale" (kontratë kornizë tri vjeçare), vlera 44,000.00 euro. Nga programi i administratës janë planifikuar 25,000.00 euro;
9. "Mirëmbajtja e automjeteve zyrtare", (kontratë kornizë tri vjeçare), vlera afër 39,000.00 euro.

Gjatë këtij viti, komuna në bashkëpunim me ASHI (Agresionin e Shoqërisë së Informacionit) ka zbatuar në platformën E-Kosova, e cila është vendosur edhe në ueb faqen e komunës së Istogut (kk.rks-gov.net/Istog), ku qytetarët mund të aplikojnë dhe të tërheqin dokumentet e gjendjes civile "online", të vlefshme për të gjitha shërbimet brenda Kosovës. Po ashtu, përmes platformës e-Kosova, komuna në bashkëpunim me ASHI ka bërë të mundur aplikimin për pagesën e faturës për taksa komunale për regjistrimin e automjeteve.

Në bashkëpunim me MAPL, komuna po kryen rifreskimin dhe azhurnimin e Intranetit komunal, ku palët mund të aplikojnë për Leje Ndërtimore në 3 faza përmes Intranetit.

Duke pasur parasysh synimet e përcaktuara në fillim të këtij viti, mund të përfundojmë se ato gjatë këtij viti janë realizuar me dinamikën e përcaktuar dhe në pajtim me planin për këtë periudhë.

Drejtoria për Administratë Komunale është e ndarë në:

1. Sektori i gjendjes civile me zyrat e vendit;
2. Sektori për administratë;
3. Qendra për shërbim të qytetarëve;
4. Arkivi komunal;
5. Zyra e prokurimit publik dhe
6. Zyra për të drejtat e njeriut dhe Komunitete.

ii. Sektori i Gjendjes Civile.

Me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më efikase, profesionale ndaj qytetarëve në Istog gjenden: 1. Zyra e Gjendjes Civile Istog, ZGJC-Vrellë dhe ZGJC-Rakosh. Kurse në Gjurakoc gjendet ZGJC-Gjurakoc e cila përfshinë edhe ZGJC-Dobrushë. Po ashtu është edhe Zyra e Gjendjes Civile në Banjë. Qytetarët mund t'i realizojnë të drejtat e tyre në rregullimin e dokumenteve personale të gjendjes civile. Tani edhe me anë të e-Kioskave ofrohen shërbime 24 orë, e cila është mundësi e mirë sidomos për njerëzit e punësuar të cilët mund t'i kryejnë shërbimet e tyre edhe gjatë ditëve të festave si dhe në fundjavë. Këto e-kioske janë të vendosura në: Istog, Gjurakoc, Vrellë, Banjë dhe Rakosh.

Shërbimi i Gjendjes Civile si shërbim në kuadër të Drejtorisë për Administratë Komunale kryen shërbime të ndryshme si: bën regjistrimin e lindjeve brenda dhe jashtë vendit në librat amë të të lindurve, lidhjen dhe regjistrimin e martesave në librin amë të martesave, regjistrimin e vdekjeve brenda dhe jashtë vendit, nxjerrjen e certifikatave të ndryshme të gjendjes civile, përfshirë, të lindjes, ekstraktin nga regjistri qendror i gjendjes civile, certifikatën e shtetësisë, të martesës, të vdekjes, të vendbanimit, të gjendjes martesore, të bashkësisë familjare, certifikatën e vdekjes, kurorëzimit, ç 'lajmërimin e vendbanimit dhe regjistrimin e adresës së re të vendbanimit, pranim e kërkesës me dokumentacionin përcjellës për parashtrimin për fitimin e shtetësisë së Kosovës dhe dorëzimin e tyre për në Departamentin për Shtetësi në Prishtinë, pranimin e kërkesave të ndryshme në kuadër të përgjegjësisë së shërbimit të gjendjes civile.

Ky shërbim në vazhdimësi ka pas volum të lartë të punëve edhe gjatë vitit 2023 sikurse në vitet tjera paraprake. Bazuar në të dhënat e ofruara nga ky shërbim brenda vitit 2023 nga zyrat e gjendjes civile janë lëshuar 25097 për përdorim brenda vendit dhe 18776 për përdorim jashtë vendit apo në total 43,873. Në këto dokumente (certifikata) përfshihen: certifikatat e lindjes, ekstrakte nga regjistri qendror i gjendjes civile, certifikata të shtetësisë, certifikata të martesës, certifikata të vdekjes, certifikata të vendbanimit, certifikata të gjendjes martesore, deklarata të bashkësisë familjare dhe vërtetime nga arkivi.

Për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2023 përveç dokumenteve-certifikatave të lartcekura, janë parashtruar edhe 174 kërkesa të ndryshme të cilat janë si në vijim:

1. Kërkesa për regjistrimin e vdekjes së mëvonshëm (82 kërkesa dhe 82 aktvendime)
2. Kërkesa për regjistrimin e lindjes së mëvonshme (07 kërkesa dhe 07 aktvendime)
3. Kërkesa për korrigjimin e emrit personal (emrit dhe mbiemrit)- (15 kërkesa dhe 15 aktvendime)
4. Kërkesa për ndërrimin e emrit personal (emrit dhe mbiemrit)- (31 kërkesa dhe 31 aktvendime)
5. Kërkesa për korrigjimin e dokumenteve të arkivuara (07 kërkesa dhe 07 aktvendime)
6. Kërkesa për anulimin e lindjeve për shkak të regjistrimit të dyfishtë (02 kërkesa dhe 02 aktvendime)
7. Kërkesa për vërtetime për konfirmimin e emrit/mbiemrit (03 kërkesa dhe 03 aktvendime)
8. Kërkesa zyrtare për korrigjim dhe anulim të akteve të lindjes, martesës dhe vdekjes (11 kërkesa dhe 11 aktvendime)
9. Kërkesa për anulimin e aktit të vdekjes (01 kërkesë dhe 01 aktvendim)
10. Kërkesa për ri regjistrimin e lindjes (01 kërkesë dhe 01 aktvendim)
11. Kërkesa për korrigjimin e aktit të vdekjes (01 kërkesë dhe 01 aktvendim)

12. Kërkesa për korrigjimin dhe plotësimin e martesës (01 kërkesë dhe 01 aktvendim)
13. Kërkesa për korrigjimin dhe ndryshimin e datës së lindjes (01 kërkesë dhe 01 aktvendim)
14. Kërkesa për vërtetimin e identiteti dhe harmonizimin e të dhënave (01 kërkesë dhe 01 aktvendim)
15. Kërkesa për njohjen e vendimit nga shteti i huaj për ndërrimin e emrit personal (02 kërkesa dhe 02 aktvendime)
16. Kërkesa për anulimin e kërkesës së parashtruar për ndërrimin e emrit personal (01 kërkesë dhe 01 aktvendim)
17. Kërkesa – ofrimi i dëshmisë për mos nxjerrjen e aktit të vdekjes (01 kërkesë dhe 01 aktvendim)
18. Kërkesa për vërtetimin e kopjes së kartonit të ish RFSJ-së (7 kërkesa dhe 7 kartonë të vërtetuar).

Dokumentet e lëshuara nga zyrat e gjendjes civile - për përdorim të brendshëm

Nr	Komuna	Certifikatë e lindjes	Ekstrakt Regjistri Qendror i Gjendjes Civile	Certifikatë e shtetësisë	Certifikatë e martesës	Certifikatë e vdekjes	Certifikatë e vendbanimit	Certifikatë e gjendjes martesore	Deklaratë e bashkësisë familjare	Vërtetim nga arkivi	Totali
1	Istog	5046	10584	108	3054	1905	2247	725	1048	380	25097
	TOTALI	5046	10584	108	3054	1905	2247	725	1048	380	25097

Dokumentet e lëshuara nga zyrat e gjendjes civile - për përdorim të jashtëm

#	Komuna	Certifikatë e lindjes	Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile	Certifikatë e shtetësisë	Certifikatë e martesës	Certifikatë e vdekjes	Certifikatë e vendbanimit	Certifikatë e gjendjes martesore	Deklaratë e bashkësisë familjare	Vërtetim nga arkivi	Totali
1	Istog	8510	2278	203	3086	436	1036	301	2765	161	18776
	TOTALI	8510	2278	203	3086	436	1036	301	2765	161	18776

iii. Sektori për Administratë

Në kuadër të këtij sektori janë: udhëheqësi i sektorit, shërbimi i teknologjisë së informimit (2 IT), autoparku (2 shërbyes), zyrtari për logjistikë (1 shërbyes), shërbimi i përkthimit (2 shërbyes) dhe shërbimi për mirëmbajtje dhe pastrim të objektit të komunës (5 stafi administrativo mbështetës).

Gjatë periudhës janar-qershor të këtij viti, stafi kryesisht janë marr me realizimin e punëve: mirëmbajtja e rrjetit të internetit dhe intranetit, instalimi i programeve softuerike në kompjuterët e stafit civil, mirëmbajtja dhe riparimet softuerike të kompjuterëve të tërë stafit civil dhe politik

të administratës komunale dhe punë të tjera të teknologjisë së informimit. Shërbimi i përkthyesve gjatë periudhës raportuese ka bërë përkthime të të gjitha dokumenteve për Kuvendin e komunës dhe komitetet e tij, për nevoja të Kryetarit të Komunës dhe tërë administratës komunale. Në këto përkthime janë përfshi edhe përkthimet simulantë dhe përkthime të tjera gjatë takimeve të ndryshme të organizuara nga administrata komunale. Nga stafi i autoparkut është bërë furnizimi i rregullt i të gjitha automjeteve zyrtare me karburante dhe evidenca e shpenzimeve të tyre sipas drejtorive komunale, është bërë mirëmbajtja e automjeteve, duke u kujdesur që të gjitha automjetet të jenë në gjendje funksionale. Nga zyra e logjistikës është bërë, sipas kërkesës së stafit, furnizimi me material të nevojshëm për zyre dhe furnizim me material higjieniko-sanitar. Nga shërbimi i mirëmbajtjes, është bërë mirëmbajtja e objektit të komunës në aspektin e pastërtisë të të gjitha zyrave, nyjave sanitare dhe korridoreve, mënjanimi i defekteve dhe riparimi i prishjeve të dyerve, dritareve mobileve dhe karrigeve të stafit si dhe mirëmbajtja e ngrohjes qendrore të objektit të komunës, duke përfshirë edhe furnizimin me lëndë djegëse.

Në kuadër të Drejtorisë, shqyrtohen kërkesa të ndryshme nga kuadri mi fushëveprimit të drejtorisë, duke përfshirë kërkesa për vijimin e stazhit të praktikës, si nga ata/ato që kanë përfunduar studimet, në të gjitha fakultetet, si në ato private dhe publike dhe studentët të cilët ende i vijnë studimet, po ashtu në të gjitha fakultetet, pa dallim, si ato private dhe publike. Gjatë kësaj periudhe raportuese janë lëshuar: 42 vendime për vijim dhe vazhdim të stazhit të praktikës, dhe 130 kërkesa dhe shkresa të ndryshme të komunikimit të brendshëm dhe komunikimit jashtë komunës. Deri tani nuk kemi asnjë vërejtje sa i përket sjelljeve të praktikantëve nga ana e stafit të administratës komunale, dhe po ashtu nuk kemi ndonjë vërejtje as nga ana e praktikantëve.

iv. Arkivi komunal.

Arkivi Komunal në Istog funksionin e tij e kryen në harmoni me dispozitat pozitive, Kushtetutën e Kosovës, Ligjit për Arkivin dhe aktet e brendshme normative të pushtetit lokal.

Për këtë periudhë raportuese aktiviteti i Arkivit Komunal ka qenë i orientuar në realizimin e detyrave të caktuara me programin e punës së Arkivit Komunal

Detyrat e caktuara me programin e punës në çështjen e mbrojtjes së lëndës arkivore dhe materialit të regjistraturës, mënyrën e ruajtjes dhe shfrytëzimin e tij për punë hulumtuese, profesionale e shkencore si dhe për punë tjera me interes për komunën dhe shoqërinë në përgjithësi në periudhën raportuese është realizuar me sukses.

Ne si punëtorë të këtij arkivi kemi punuar me përkushtimin më të madhe edhe përkundër të gjitha vështirësive që janë paraqitë vetëm e vetëm që materiali arkivor të ruhet dhe klasifikohet në mënyrën më të mirë të mundshme.

Motivim shtytës ka qenë edhe angazhimi institucional për krijimin e kushteve të domosdoshme për punë më efikase për ne si punëtorë të këtij sektori por njëkohësisht edhe krijimi i kushteve më të favorshme për ruajtjen e materialit arkivor dhe të regjistraturës në këtë sektorë me rëndësi të posaçme shoqërore.

Për periudhën raportuese është punua sipas rrethanave dhe kushteve që kanë qenë të diktuar nga rrethanat faktike të riparimit të brendshëm të Shtëpisë së Kulturës .

Faktori i tillë është reflektuar edhe në kryerjen e punëve fillestare jo edhe aq të favorshme sepse është punuar me lëndë në pluhurin e koncentruar nga qëndrimi i tyre në kushte jo aq të favorshme në vendin ku është deponua kjo lëndë arkivore. Të gjitha këto lëndë që kanë arrit nuk kanë qenë të sistemuara.

Gjatë periudhës raportuese Janar-Dhjetor 2023 është klasifikua materiali arkivor i cili është sistemuar dhe riklasifikuar në 18. (tetëmbëdhjetë) kuti arkivore dhe atë siç vijon:

Materiali arkivor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mjedis është klasifikuar dhe sistemuar në 6 (gjashtë kuti arkivore).

Është vazhduar klasifikimi i lëndës arkivore që ka arrit nga më parë nga Institucionet e pushtetit lokal

Me këtë material të arkivuar janë plotësuar gjithsejtë 8 (tetë) kutia arkivore.

Është klasifikuar edhe materiali i grumbulluar arkivor i pranuar një vite më parë. Kryesisht prioritet i është dhanë klasifikimit dhe sistemit të lëndës arkivore që ka të bëjë me projekte të ndryshme banesore dhe atyre për leje ndërtimi.

Për periudhën raportuese prioritet i është dhënë edhe kërkesave të palëve prej 43 kërkesave të parashtruara në bazë të të dhënave që ka poseduar ky arkiv me të dhëna të kërkuara përgjigjja u është dhanë palëve në 32 kërkesa. Në 11 (njëmbëdhjetë) kërkesa tjera palët janë udhëzuar që të drejtat e tyre t'i realizojnë në organet kompetente ku është në ruajtje lënda arkivore.

Për hulumtime shkencore bashkëpunim në shfrytëzimin e lëndës arkivore ka pasur edhe me (5) pesë studentë të cilët me revers e kanë shfrytëzuar lëndën e krijuar arkivore për hulumtime shkencore.

Edhe se është punuar në realizimin e detyrave të parapara me programin e punës ende ka lëndë të pa klasifikuar arkivore për shkak të dorëzimit të tij pa u përmbushë kushtet ligjore për arkivim . njëkohësisht materiali arkivor i dorëzuar në as një raste nuk ka qenë i sistemuar ashtu siç kërkohet me dispozitat pozitive.

Për këtë vërejtjet dhe sugjerimet eventuale që mund të paraqiten janë të mirëseardhura me kusht që në të ardhmen puna të perfeksionohet dhe lëshimet e mundshme të korrigjohen.

v. Qendra për shërbim të qytetarëve.

Përmes kësaj zyre qytetarët më lehtë mund t'i adresojnë kërkesa e tyre dhe të marrin përgjigje. Në këtë kuptim të gjitha kërkesat për të gjitha organet komunale kalojnë përmes këtij shërbimi. Gjithashtu nga kjo zyre udhëzohen të gjithë qytetarët për realizimin e të drejtave të tyre në pushtetin lokal dhe për procedurat e realizimit të këtyre të drejtave. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023, në këtë shërbim janë pranuar një numër i madh i kërkesave të cilat gjenden në tabelën e mëposhtme të drejtuar të gjitha drejtoritë, kryetarit dhe kuvendit.

Numri i kërkesave sipas Drejtorive, për periudhën Janar-Dhjetor 2023:

Nr.	Drejtoritë/Departamenti	Të pranuar	Të arkivuara
00	Kuvendi Komunal	01	0
001	Zyra e Kryetarit	225	196
02	Drejtoria për Administratës	98	50
03	Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë	2411	1454
04	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim,	238	66
05	Drejtoria për Arsim	601	772

06	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	595	133
07	Drejtoria i Inspektionit	117	19
08	Drejtoria për ShPMSH & Emergjencia	906	760
09	Drejtoria i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Hidroekonomi	409	300
10	Zyra për Komunitete dhe Kthim	69	7
11	Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis	540	428
12	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	97	99
13	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	20	10
Gjithsejtë		6,327	4,294

Numri i dokumenteve të lëshuara/proceduara për periudhën Janar-Dhjetor 2023:

Nr.	Lloji i dokumentit	Totali
1	Deklaratë për mbajtës të familjeve	343
2	Protokolli dalës shkresa të ministrive të protokolluara	290
3	Ekspedimi i postës Rek. dërgesave në postë- përgjigje nga Drejtoritë K.K	609
4	Vulosje të dokumenteve	11.200
5	Pranimi i dërgesave nga posta në K.K-Istog	487
6	Vërtetim të adresës	548
Gjithsejtë		13,477

Pagesat e administratës për periudhën Janar-Dhjetor 2023:

Nr.	Lloji i dokumentit	Euro
1	Pagesat e administratës-palët	2.633
2	Pagesa në arkë	4.564
Gjithsejtë		7,197

vi. Zyra e Prokurimit

Ju prezantojmë aktivitetet e zhvilluara të cilat janë të proceduara nga zyra e prokurimit: publikimi i njoftimit për kontratë anulimet për arsyeje të tejkalimit të vlerës së planifikuar dhe të mos marrje pjesë konkurrencë të operatorëve ekonomik deri të nënshkrimi i kontratës:

1. Plani i prokurimit për vitin buxhetor 2023 përmban njëqind e nëntëdhjetë e dy (192) aktivitete të prokurimit: procedurat, llojet e prokurimeve, vlerat e prokurimeve-kontratave;
2. Numri i numri i aktiviteteve të iniciuara deri me 31 dhjetor 2023 me plan të prokurimit është njëqind e pesëdhjetë e tre (153);
3. Numri i numri i aktiviteteve të iniciuara që nuk kanë qenë në plan të prokurimit është tridhjetë e nëntë (39);
4. Numri i kontratave të nënshkruara është njëqind e gjashtëdhjetë e katër (164) (duke llogaritur se 1 aktivitet me termë të referencës mund të ketë dy apo me shumë lot-e);
5. Realizimi i planit të prokurimit për aktivitete të planifikuara është realizuar deri me 24.12.2023 është – 100%
6. Realizimi i aktiviteteve të prokurimeve të planifikuara në raport me aktivitetet-prokurimet të proceduara nga zyra e prokurimit është 125.49%;
7. Kërkesa për rishqyrtim gjatë kësaj periudhe kanë qenë 16 sosh dhe përveç njëres (1) e cila është në trajtim dhe shqyrtim pranë OSHP-së të gjitha aktivitetet tjera - respektivisht janë vendosur në favor sipas rezultatit të vendimeve për dhënien kontratave zyres së prokurimit- autoritetit kontraktues.

Njësia e prokurimit ka përmbushur në tersi detyrat me përgjegjësi të cilat i ka parapara legjislacioni përkatës, pra LPP-ja Rregullorja P.P udhëzimi operativ i PP dhe legjislacioni dytësor

vii. Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete

Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete si mekanizëm monitorues për respektimin e të drejtave të njeriut në relacionin komunë-qytetarë, funksion si sektor/njësi e veçantë në kuadër të Drejtorisë për Administratë Komunale.

Misioni i Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete është vëzhgimi i respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe reagimi për vënien e tyre në vend, sensibilizimi i qytetarëve për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre, përmirësimi i akteve nënligjore komunale, praktikës për zbatimin e këtyre akteve, barazia gjinore, të drejtat e fëmijëve, mundësi të barabarta dhe mos diskriminim, të drejtat e komuniteteve, përdorimi i gjuhëve, kundër trafikimit me qenie njerëzore, personat me aftësi të kufizuara.

Struktura e Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete :

1. Udhëheqësja e Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete;
2. Zyrtarja për Barazi Gjinore e caktuar edhe në detyrat e Zyrtares kundër Diskriminimit dhe
3. Zyrtarja për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Rintegroim.

Në periudhën Janar-Dhjetor 2023 janë mbajtur këto aktivitete të parapara me planin e punës:

- Tryezë dhe manifestim në bashkëpunim me OSBE-në më rastin e shënimit të 8 Marsit "Dita Ndërkombëtare e Gruas". Tema kryesore e kësaj tryeze ishte "Sfidat, vështirësitë dhe të arriturat e grave". Pjesë e kësaj tryeze ishte edhe Kryetari i Komunës z.Illir Ferati,

Drejtori i Zyrës Rajonale të OSBE-së, z. Riccardo Celleghini, Nënkryetari i Komuniteteve z. Valmir Rama, Drejtori i Drejtorisë për Administratë Komunale z. Arben Kabashi.

- Takime njoftuese me shkolla dhe institucionet parashkollore në Komunën e Istogut për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Qëllimi i këtyre takimeve ishte njoftimi i drejtorëve të shkollave dhe drejtoreshave të institucioneve parashkollore për bashkëpunimin në të ardhmen me Zyrtaren për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim znj. Vlora Gjoci në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve për sigurimin e një mirëqenie më të mirë për fëmijët. Qëllim tjetër i këtyre takimeve ishte edhe diskutimi për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe fushatave të ndryshme ndërgjegjësuere e edukuese për tema të ndryshme mbi respektimin e të drejtave të fëmijëve, parandalimin e dukurive negative si format e ndryshme të dhunës, bulëzim, delikuenca, dhe përdorimin e substancave narkotike, si dhe takimet me prindër që të promovojmë mënyrat jo të dhunshme të disiplinimit të fëmijëve.
- Në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport u shënua 21 Marsi “Dita Botërore e Sindromes Daun” dhe u mbjellën 21 lule në oborrin e OJQ “Handikos” nga këta persona dhe pas aktivitetit u mbajt një koktej rasti. Ky aktivitet kishte si qëllim edhe ngritjen e vetëdijes së qytetarëve mbi nevojat dhe realizimin e të drejtave të personave me Sindromën Doën dhe trajtimin e barabartë dhe jo diskriminues me qëllim të integritetit të tyre më të lehtë në komunitet.
- Në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit me rastin e shënimit të 2 – Prillit “Dita Ndërkombëtare e Autizmit”, ka mbajtur një tryezë diskutimi me përfaqësues nga shkolla (drejtorë, psikologë, pedagog, asistentë të fëmijëve më aftësi të kufizuara, mësues mbështetës), zyrtarë komunal, përfaqësues nga OJQ, përfaqësues nga Qendra për Punë Sociale dhe prindër të fëmijëve me autizëm.
- Me rastin e shënimit të Muajit Prill - Muaji Ndërkombëtar i Ndërgjegjësimit për Autizmin nga Zyrtarja për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim znj. Vlora Gjoci janë mbajtur ligjërata informuese për autizmin me nxënës nga klasat e IV dhe të V, të cilët janë informuar për çrregullimin e spektrit të autizmit, sjelljen dhe kujdesin që duhet të tregojmë të gjithë ne në raport me fëmijët me autizëm që t’i pranojmë dhe t’i trajtojmë në mënyrë të barabartë dhe të mos lejojmë asnjë formë të paragjykitimit apo diskriminimit ndaj tyre. Gjatë këtyre ligjëratave u theksua rëndësia e mbështetjes që duhet të jetë nga familja, shoqëria, profesionistët dhe shteti në përgjithësi për një integrim dhe mirëqenie me të mirë të fëmijëve me autizëm.
- Në bashkëpunim me OJQ “Terre des Hommes”, organizoi një tryezë punë me rastin e 12 Prillit “Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve në Situatë Rruge”. Qëllimi i tryezës ishte diskutimi për parandalimin e dukurisë negative të kërkim-lëmshës nga fëmijët si dhe organizimi i një fushatë për vetëdijesimin e qytetarëve për shkaqet dhe pasojat që krijojnë dhënia e lëmshës, me theks të veçantë tek fëmijët në situatë rruge. Po ashtu u shpërndanë edhe fletushka.
- Në bashkëpunim me Drejtorinë për Mirëqenie Sociale me rastin e shënimit të 15 Majit - Dita Ndërkombëtare e Familjes realizoj vizitë tek familjet strehuese në Istog, me qëllim

- të diskutimit për misionin dhe sfidat e tyre si familje strehuese gjatë strehimit të fëmijëve pa përkujdesje prindërore, të keqtrajtuar e të neglizhuar nga familja e tyre biologjike si dhe ofrimin e mbështetjes që ju ofrohet nga komuna këtyre familjeve. Këto familje u përkrahen më pako ushqimore dhe me një shumë financiare në vlerë prej 200 euro.
- Në bashkëpunim me Drejtorinë për Kadastër dhe Gjeodezi me përkrahjen e OSBE-së në muajin Maj organizoi dhe mbajti dy takime me qëllim të diskutimit, informimit dhe vetëdijesimit të grave për të drejtën në trashëgimi dhe pronë. Pjesëmarrës në këto takime ishin edhe Nënkrjetari i Komuniteteve z. Valmir Rama, Drejtori i Drejtorisë për Administratë Komunale z.Arben Kabashi dhe Agon Dreshaj, Drejtor i Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi. Këto takime u mbajtën në SH.F.M.U “Hysni Zajmi” në Vrellë dhe në SH.F.M.U “Martin Camaj” në Gjurakoc. Në këtë takim u shpërndanë fletushka me të dhëna për të drejtën në trashëgimi dhe pronë.
 - Në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit me rastin e shënimit të 1 Qershorit “Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve” mbajti një takim në të cilin ishin prezentë Kryetari i Komunës z.Illir Ferati, përfaqësues nga shkolla dhe nxënës të shkollës së mesme të ulët “Bajram Curri” në Istog, të cilët gjatë takimit me kryetarin kishin mundësin të diskutojnë për të drejtat e tyre, ngritjen e mirëqenies dhe mbrojtjen e interesit më të mirë të fëmijëve. Për fëmijët të cilët ishin të pranishëm në këtë takim u shpërndanë dhurata të cilat përmbanin material didaktik, duke shtuar në fund që buzëqeshja dhe entuziazmi i tyre i mbushur plotë jetë është gëzimi dhe motivimi ynë për të bërë gjithçka që fëmijët tanë ta kenë një jetë të sigurtë.
 - Në bashkëpunim me OJQ “Vision 02” dhe përkrahjen e OSBE-së, me qëllim të shënimit të 24 Qershorit “Dita nacionale e komunitetit Egjiptian” u mbajt tryezë e rrumbullakët me temën “Sfidat dhe angazhimet e institucioneve për realizimin e kërkesave të komunitetit Egjiptian dhe integrimi i tyre në shoqëri”. Pjesë e kësaj tryeze ishte edhe Nënkrjetari i Komuniteteve z. Valmir Rama, Drejtori i Drejtorisë për Administratë Komunale z.Arben Kabashi, Drejtori i Zyrës Rajonale të OSBE-së, z.Riccardo Celleghini, përfaqësues nga UNMIK dhe shoqëria civile. Qëllimi i kësaj tryeze ishte diskutimi lidhur me sfidat dhe rritja e shkallës së angazhimit e institucioneve për realizimin e kërkesave të komunitetit egjiptian dhe integrimin e tyre në shoqëri.
 - Në bashkëpunim me Drejtorinë për Shëndetësi dhe OSBE gjatë Muajit Tetor, Muaji Rozë, ka organizuar fushata ndërgjegjësuere kundër kancerit të gjirit. Qëllimi i fushatave ishte ndërgjegjësimi i grave për parandalimin, trajtimin dhe kujdesin që duhet treguar për këtë sëmundje. Takimet u mbajtën në tri lokacione: SHFMU “Trepça” në Banjë, SHFMU “Ismail Qemaili” në Saradran dhe SHFMU “Martin Camaj” paralelja e ndarë në Serbobran. Pjesëmarrëse në këto takime ishin mbi njëqind gra të moshave të ndryshme edhe nga radhët e komuniteteve. Gratë u inkurajuan që bëjnë kontrole të vazhdueshme pasi që zbulimi i hershëm është mbijetesë;
 - Në bashkëpunim me Shoqatën Komunale për të Verbër, me seli në Istog me rastin e shënimit të 15-të Tetorit “Dita Ndërkombëtare e Shkopit të Bardhë”, me kërkesën e Shoqatës Komunale të Verbërve me seli në Istog është organizuar një shëtitje njëditore për anëtarët e shoqatës në qytetin e Prizrenit.

- Në bashkëpunim me përfaqësues nga Stacioni Policor në Istog, Zyrtarja për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim nga data: 18 tetor deri 18 nëntor 2023 ka organizuar dhe mbajtur “Fushatën Vetëdijesuese Kundër Trafikimit me Njerëz”. Qëllimi i fushatës ishte parandalimi i trafikimit të qenieve njerëzore, si një nga format me të rënda të shkeljes së të drejtave të njeriut dhe ngritja e vetëdijes së popullatës së gjerë për rolin dhe rëndësinë e identifikimit të hershëm të viktimave potenciale të trafikimit, faktorët dhe pasojat e trafikimit, si dhe vetëdijesimi për raportimin e rasteve të trafikimit tek institucionet përgjegjëse. Kjo fushatë është mbajtur me nxënësit e klasave të VIII, IX, X, XI në komunën tonë. "Fushatat Vetëdijesuese Kundër Trafikimit me Njerëz 2023" janë mbajtur në këto shkolla dhe institucione: F.SH.M.U “Trepça” Banjë, F.SH.M.U “Hysni Zajmi” Vrellë, F.SH.M.U “Zymer Zeka” Kalijan, F.SH.M. U “Bajram Curri” Istog, IAAP “Mithat Frashëri” Gurakoc, F.SH.M.U “Tre Dëshmorët” Uçë, F.SH.M.U “Avni Rustemi” Zallq, Gjumnazi “Haxhi Zeka”, Takim i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, F.SH.M.U “Martin Camaj, Stacioni Policor në Istog si dhe shpërndarja e posterave kundër trafikimit me njerëz tek nxënësit dhe qytetarët në komunë. Mesazhi i fushatës “TRAFIKIMI PREKË TË GJITHË! TA MBROJMË VETËN DHE FËMIJËT TANË!“, slogani “MOS HESHT”
- Me rastin e shënimit të 20 Nëntorit- Dita Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, Zyrtarja për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim në kuadër të Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete ka mbajtur një ligjëratë me nxënës në SHFMU “Mehmet Akif” në Shushicë. Qëllimi i ligjëratës ishte që t’i informoj nxënësit për të drejtat e tyre që iu garantohen në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, ligjin për mbrojtjen e fëmijës si dhe akte ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë. Kjo ditë festohet për ndërgjegjësimin e fëmijëve për të drejtat e tyre dhe parandalimin e çdo formë të dhunës apo abuzimi duke ju garantuar mbrojtje dhe mirëqenie për të gjithë fëmijët dhe obligimin e secilit që ato të drejta duhet të zbatohen në praktikë dhe asnjëherë të mos shkelen;
- Në bashkëpunim me Qendrën për Mirëqenies e Gruas dhe përkrahjen e NDI-së, në kuadër të fushatës globale kundër dhunës konkretisht “16 Ditë të Aktivizimit kundër Dhunës në Bazë Gjinore”, janë organizuar dhe mbajtur tri takime informuese me nxënës dhe katër tryeza diskutimit me aktorë të ndryshëm institucional: përfaqësues nga policia, Qendra për Punë Sociale, Këshillë Juridike Falas, arsimit, shëndetësia, OJQ-të nga komuna e Istogut, përfaqësueset të KK-së dhe përfaqësues nga komuna. Në këto tryeza u diskutua në përgjithësi për dukurinë e dhunës, format e saj, pasojat e dhunës, identifikimin, parandalimin, mekanizmat dhe raportimin e dhunës, po ashtu për pjesëmarrësit u shpërndanë edhe broshura. Në çdo aktivitet gjatë fushatës u promovua slogani i përzgjedhur për këtë vit “SOT DHE ÇDO DITË TJETËR” që ka qëllim luftimin e dhunës sot dhe çdo ditë tjetër. Qëllimi i kësaj fushatë është ngritja e vetëdijes dhe adresimi institucional për luftimin e këtij fenomeni mjaftë shqetësues për tërë botën edhe në Kosovë. Pjesëmarrës tjerë në këto tryeza ishin edhe: z.Valmir Rama, Nënkretar i komunës për Komunitete, z.Arben Kabashi, Drejtor i Drejtorisë për Administratë Komunale dhe drejtorë të drejtorive përkatëse;
- Në bashkëpunim me OJQ “Handikos” nga Istogu, me rastin e shënimit të 3 - Dhjetorit, Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara u mbajt një tryezë diskutimi. Qëllim ishte mbështetja e Personave me Aftësi të Kufizuara si dhe diskutimi i përbashkët për kërkesat dhe nevojat e tyre, mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, ofrimin e qasjes, pjesëmarrjen e tyre në sfera të ndryshme të shoqërisë, sfidat dhe

- vështirësitë që hasin përgjatë përditshmërisë. Pjesëmarrës në këtë tryezë ishte edhe Drejtori i Drejtorisë për Administratë Komunale z.Arben Kabashi;
- Zyrtarja për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim në kuadër të Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete - Drejtoria për Administratë Komunale ka mbajtur sesione informuese me temën: “Parandalimi i Bullizmit Delikuencës dhe Dhunës Emocionale”, Sesionet informuese janë mbajtur me nxënësit e klasave të VI, VII në F.SH.M.U “Hysni Zajmi” në Vrellë, “Bajram Curri” në Istog, dhe “Martin Camaj” në Gurrakoc;
 - Në bashkëpunim me OJQ “Creative Youth Group “me seli në Istog, u mbajt një tryezë diskutimi me rastin e shënimit të 10 - Dhjetorit “Dita Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut”. Qëllimi i kësaj tryeze ishte diskutimi i përbashkët lidhur me respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në përgjegjësi e në veçanti u diskutua rreth aktiviteteve dhe tryezave të diskutimit që ka organizuar dhe mbajtur Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete në bashkëpunim me drejtoritë e fushave përkatëse dhe OJQ-të përgjatë vitit 2023, me qëllim të ngritjes së vetëdijes dhe sensibilizimin e qytetarëve lidhur me të drejtat dhe liritë e tyre. Pjesëmarrës tjerë në këto tryeza ishin edhe: z.Valmir Rama, Nënkyetar i komunës për Komunitete, z.Arben Kabashi, Drejtor i Drejtorisë për Administratë Komunale, përfaqësues nga OJQ-të , asamblistë, këshilla juridike falas dhe zyrtarë të drejtorive përkatëse
 - Është themeluar Ekipi për të Drejtat e Fëmijës në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës Nr.06/L-084 dhe Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.06/2022 për Themelimin dhe Funksonimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës po ashtu dhe është miratuar Plani i Punës së Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, Istog (2024-2026).
 - Është nënshkruar marrëveshja për institucionalizimin e Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje dhe mënyrën e funksionimit të tij në komunën e Istogut. Qëllimi i nënshkrimit të kësaj marrëveshje është përmirësimi i nivelit të sigurisë dhe efikasitetit për parandalimin, trajtimin dhe riintegrimin e rasteve të dhunës në familje, duke siguruar në vazhdimësi mirëqenie për këtë kategori personash që janë viktime të dhunës në familje, përmes institucionalizimit të Mekanizmit Koordinues dhe monitorimit të zbatimit të politikave. Koordinatorë e këtij mekanizmi u caktua Zyrtarja për Barazi Gjinore.
 - Udhëheqësja e Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete është caktuar anëtare e Komitetit për Barazi Gjinore dhe zyrtare raportuese për performancë po ashtu sipas autorizimit të drejtorit ushtron detyrat e zyrtares administrative për shpenzim të buxhetit të programit buxhetor të administratës. Zyrtarja për Barazi Gjinore është anëtare e KKSB-së dhe anëtare e Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje ndërsa Zyrtarja për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Riintegrim është anëtare e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës dhe në kuadër të këtij ekipi kryen punët tekniko-administrative.
 - Janë monitoruar mbledhjet e Kuvendit Komunal dhe trupave të KK-së, dëgjimeve me qytetarë, takime tjera në kuadër të komunës dhe pjesëmarrje në trajnime, tryeza të ndryshme nga fusha e të drejtave të njeriut.

Për realizimin e të gjitha aktiviteteve, të lartpërmendura të këtij Sektori, nga nënprogrami buxhetor për barazi gjinore, nga kategoria e shpenzimeve subvencione dhe transfere janë

planifikuar dhe janë shpenzuar 5,000.00 euro. Po ashtu për realizmi i aktiviteteve të cekura janë financuar edhe nga donatorët si: OSBE, Terres de Homnes dhe donatorët të tjerë, për çka i falënderojmë.

DREJTORIA PËR INSPEKSION

RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-DHJETOR 2023

Në përputhje me Planin e Punës për periudhën raportuese Janar-Dhjetor 2023, të Drejtorisë për Inspeksion, në kuadër të sektorëve përkatës, janë realizuar aktivitete inspektuese në terren, si dhe veprime administrative në zyrë, me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjshmërisë dhe rregulloreve përkatëse komunale.

Sikurse edhe gjatë vitit paraprak, përmes strukturës së Drejtorisë për Inspeksion janë mbuluar këta sektorë, duke përfshirë sektorin e ndërtimit (me 2 pozita inspektoriale), sektorin e tregut (1 pozitë), sektorin e mjedisit – ambientit (1 pozitë), sektorin e veterinarisë (1 pozitë) dhe sektorin e komunikacionit (1 pozitë).

Gjatë periudhës raportuese, si rezultat i aktiviteteve inspektuese të realizuara në vazhdimësi në terren, janë arritur rezultate konkrete në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë, siç është prezantuar në të dhënat vijuese, e që kanë të bëjnë me:

1. Ruajtjen e brezit mbrojtës të rrugëve regjionale dhe lokale në territorin e Komunës me ç’rast janë:

- hartuar 67 procesverbale.
- janë lëshuar 9 aktvendime .
- 10 rrethime të objekteve me shirit.
- 42 ri-inspektime
- 12 përgjigje në bazë të kërkesës së palës.
- 7 gjoba mandatare.
- 2 rrënime të objekteve.

2.Punët e Inspektorit të Ndërtimit - Zona Urbane

Punët e Inspektorit të Ndërtimit - Zona Urbane për periudhën raportuese janë zhvilluar në bazë të planit të punës për Janar-Dhjetor 2023 të Zyrës së Inspeksionit dhe planit operacional të hartuar nga bartësi i pozitës.

Aktiviteti inspektues ka qenë i fokusuar dhe i mbështetur në bazë të kompetencave të akteve ligjore në fuqi për pozitën e punës së lartëshënuar dhe ka qenë i përqendruar në:

- **Inspektime për mbikëqyrje të zbatimit të dispozitave të ” Ligjit Ndërtimit”**

Aktiviteti kryesor i Inspektorit të Ndërtimit ishte parandalimi i ndërtimeve jolegale, kontrollimi, evidentimi, inçizimi dhe ndërmarrja e hapave konkret si në parandalim ashtu edhe në ndjekjen e procedurave ligjore për objektet e ndërtuara si në pronë private ashtu edhe në pronë publike.

Aktiviteti i shtuar i Inspektorit të ndërtimit ka rezultuar me ndaljen e ndërtimeve pa leje, me theks të veçantë në pjesët urbane të qytetit. Këto masa të inspektorit kanë ndikuar që të shtohen kërkesat për leje ndërtimore dhe legalizim të objekteve banesore dhe afariste.

Ku gjatë këtyre inspektimeve në teren nga ana e inspektorit të ndërtimit në katër qendrat urbane Istog, Gurakoc, Banjë dhe Vrellë, janë bërë 35 inspektime dhe 41 riinspektime, 94 procesverbale, 11 aktvendime, 4 gjoba mandatare.

Me aktvendim u është ndëprerë puna 11 objekteve të ndërtimit dhe atë:

Istog.....6
Banjë.....2
Vrellë.....1
Gurakoc...2

Kemi edhe një aktvendim për rrënimin e objektit për shkak të rrezikshmërisë nga shembja. Kemi pranuar 51 kërkesa nga investitorët dhe përfaqësuesit e punimeve të objekteve për të bërë inspektimin dhe protokollin mbi përfundimin e të gjitha fazave gjatë ndërtimit, siç parashihet me ligjin e ndërtimit.

Njoftim për Policinë e Kosovës, stacionin policor në Istog, për asistencë në ekzekutimin e aktvendimeve në teren për 2 objekte.

Po ashtu, me një kërkesë, jemi drejtuar Drejtorisë për Kadaster dhe Gjeodezi për daljen e gjeodetëve në teren për inqizim të objekteve.

4 aktvendime për rrënimin e objekteve ekzistuese për shkak të rrezikshmërisë nga shembja.

3.Mbikëqyrjen e fushës së tregtimit, qarkullimit dhe ekspozimit të mallrave, dhe të shërbimeve, si dhe ligjshmërisë së funksionimit të veprimtarive të tilla biznesore janë zhvilluar këto aktivitete:

- Gjatë kësaj periudhe raportuese janë hartuar 53 procesverbale.
- Janë hartuar 7 procesverbale lidhur me plotësimin e kushteve higjeniko –sanitare dhe kushteve tjera minimale-teknike për subjektet afariste të cilat kanë filluar apo vazhduar aktivitetin e tyre afarist.
- Janë lëshuar 7 aktvendime për plotsiminin e kushteve të lartcekura dhe është dhënë pëlqimi për ushtrimin e aktivitetit afarist.

- Janë hartuar 23 procesverbale gjatë kontrolleve rutinore inspektuese nëpër marketet dhe supermarketet e shitjes me pakicë të mallrave . Inspektime këto që kanë të bëjnë me dukurinë e rritjes së çmimeve për artikujt ushqimor siq janë vaji , vezët , sheqeri, reklamimi dhe shitja e cigareve elektronike, mos vendosja e flamujve ne afersi te produkteve te origjines, mashtrimet e konsumatoreve me çmime te produkteve- mashtimi i konsumatorit me kinse lirime ditore etj.
 - Janë hartuar 6 procesverbale lidhur me ankesën e konsumatorëve ndaj operatorëve ekonomik ndaj te cileve jsne marrë edhe masa ligjore bazuar ne ligjet ekzistuese ne fuqi.
 - Janë hartuar 5 procesverbale gjatë inspektimeve të jashtzakonshme në mbështetje nga Policia e Kosovës , inspektime këto që kanë të bëjnë me mosrrespektimi ne orarit të punës nga subjektet afariste.
 - Janë hartuar 11 procesverbale lidhur me shitjen ambulatore në rrugë dhe trotuare.
 - Janë lëshuar 6 gjoba mandatare.
 - Janë lëshuar 6 aktvendime për shqiptimin e gjobave.
 - Është hartuar 1 procesverbal në shtëpinë e pleqëve në Istog
- Si dhe shumë aktivitetëe rutinore të përditshme të shoqëruara me vërejtje gojore .

4. Në sektorin e mbrojtjes së mjedisit - ambientit, gjatë kësaj periudhe raportuese janë zhvilluar këto aktivitete:

- Janë hartuar 28 procesverbale inspektuese .
- Janë kryer 36 inspektime.
- Janë kryer 36 ri-inspektime.
- Janë shqyrtuar 8 kërkesa të palëve të cilat kanë marrë zgjidhje.
- 1 lëndë është në procedurë .

5. Sektori i veterinarisë: Gjatë periudhës raportuese, inspektori i veterinarisë, në bazë të ligjeve të përkatëshme në fuqi, ka zhvilluar këto aktivitete:

- Aktivitetet lidhur me therjen, shitjen dhe qarkullimin e mishit, ku janë realizuar 1080 vizita-inspektime të therjes dhe vulosjes së mishit.
- 12 Procesverbale-inspektime të hurdhave të peshkut.
- 6 Procesverbale-mbytja e kafshëve nga ujku.
- 3 Procesverbale-mbytja e kafshëve nga ariu.
- 4 Procesverbale me rastin e semundjes dhe ngordhjes të kafshëve dhe shpezëve.

6. Në sektorin e komunikacionit:

Në bazë të kompetencave të larta të përmendura, Inspektori i autorizuar i Komunikacionit ka paraqitur këtë raport të aktiviteteve të kryera.

- Janë hartuar 16 procesverbale gjatë inspektimit në transportin publik të udhëtarëve, auto-taxi, transport publik nderurban dhe ndërprerjen e transportit ilegal të udhëtarëve.
- 76 Inspektime të operatorëve ekonomikë të transportit publik të udhëtarëve me autobus dhe auto-taxi në territorin e komunës së Istogut.

Krahas punëve dhe obligimeve të planifikuara, në periudhën janar - dhjetor 2023, kësaj Drejtorie i janë parashtruar edhe kërkesa të tjera nga ana e qytetarëve dhe bizneseve për realizimin e aktiviteteve të ndryshme inspektuese në terren, të cilat kanë marrë përgjigje bazuar në ligjet, udhëzimet administrative dhe rregulloret komunale në fuqi.

DREJTORIA PER BUXHET DHE FINANCA ***RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-DHJETOR 2023***

Në afatin ligjor, është përgatitur dhe dorëzuar në Ministrinë e Financave plani i buxhetit në formën sistemit të zhvillimit buxhetor (BDMS) për vitet 2024-2026. Në fillim të vitit buxhetor 2023, në Thesarin Qendror është dorëzuar rrjedha e planit të parasë për të gjitha programet dhe nën-programet buxhetore në bazë të planit të shpenzimeve 2023-2025. Me 30 shtator 2023, është aprovuar në Kuvend dhe dorëzuar Planifikimi i Buxhetit për vitet 2024-2026 në Ministrinë e Financave. Të hyrat vetanake janë të përcaktuara me Rregulloren Komunale mbi të Hyrat, në të cilën janë determinuar cilat të hyra ka të drejtë t'i arkëtojë komuna, si tatimi në pronë, taksat për dhënie e lejeve të ndërtimit, taksat nga licencat e lokaleve, taksat e shërbimeve komunale, si dhe të hyrat nga dënimet e shqiptuara në komunikacion, etj. Dhënia e shërbimeve të përditshme mbi buxhetin dhe shpenzimet buxhetore bëhet përmes platformës "FreeBalance". Në vijim, do t'u njoftojmë me burimet e financimit të Plan-buxhetit për vitin 2023 dhe mjetet e bartura në vitin 2023 nga viti 2022, si dhe realizimi i shpenzimeve nga 01.01.2023 gjerë më 31.12.2023.

Sipas Kategorive Ekonomike 2023										
Kategorite Ekonomike	Sum of Buxheti Aktuali	Sum of Allocated	Sum of Aktual	Sum of Zotim /Obligimet në pritje	Sum of Buxheti FreeBalançe	Sum of Suficiti nga Alokimet	% e suficitit nga Alokimet	Ndarjet Buxheto re sipase ligjit 2023	Diferenca në mes të ndarjeve buxheto re ligji 2023 dhe në fund të vitit fiskal 2023	% e shpenzimit në raport me alokimet
	A	B	C	D	A - (C + D)	B-C	C/B			
11 PAGA DHE SHITESA	8,110,972.51	8,110,972.51	8,088,978.35	-	21,994.16	21,994.16	0.27	6,565,231.00	1,545,741.51	99.73
13 MALLRA DHE SHËRBIME	1,966,063.35	1,966,063.35	1,896,275.08	44,313.24	25,475.03	69,788.27	3.55	1,924,337.00	41,726.35	96.45
14 SHPENZIME KOMUNALE	200,000.00	200,000.00	198,874.32	1,125.65	0.03	1,125.68	0.56	200,000.00	-	99.44
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	513,627.46	513,627.46	478,413.00	34,642.54	571.92	35,214.6	6.86	370,000.00	143,627.46	93.14
30 PASURITË JOFINANCIARE	4,468,	4,468,974.	4,030,006	180,536.	258,431.8	438,968.	9.82	3,991,90	477,071.	90.18

	974.79	79	.08	91	0	71	3.00	79	
38 REZERVAT						-			
	15,259								
	,638.1	15,259,63	14,692,54	260,618.	306,472.9	567,091.	13,051,4	2,208,16	
TOTALI	1	8.11	6.83	34	4	28	71.00	7.11	96.28

Sqarim: Në tabelën e mësipërme janë paraqitur të dhënat sipas Sistemit FreeBalance SIMFK(Sistemi i Menagjimit të Financave të Kosovës) të datës 31.12.2023.

Nga shifrat nga tabela shihet trendi i mjeteve të planifikuara dhe të shpenzuara nga buxheti qendror dhe të hyrat vetanake nga niveli lokal 2023 dhe të mjeteve të bartura nga të hyrat vetanake të vitit 2022 në vitin 2023 , për këtë periudhë raportuese.

Trendi i shpenzimeve dhe përcaktimi i tyre varet kryesisht nga trendi i të hyrave vetanake të arkëtuara të cilat janë kontribut i qytetarëve nga tatimi dhe taksat e ndryshme komunale nga të cilat varet realizimi projekteve parësore të komunës të cilat projekte kryesisht janë në të mirën e qytetareve me qëllim të përmirësimit të kushteve dhe standardin jetësor.

Të Hyrat Vetanake Komunale

Te hyrat vetanake të planifikuara për vitin 2023 janë në shumë prej 1,244,588.00 €. Deri me datë 31.12.2023 janë mbledhur (arkëtuar) të Hyra Vetanake Komunale në shumën prej 1,528,552.00 €, në përqindje i bie 122.82%. Me një fjalë, janë grumbulluar (arkëtuar) rreth 22.82% më shumë se Plani i Buxhetit për të Hyrat Vetanake Komunale.

Janë kryer këto punë dhe detyra të punës:

- Përpunimi i të Hyrave Komunale dhe ndarja sipas Kodeve ekonomike
- Rexhistrimi i të Hyrave vetanake në sistemin FreeBalance
- Përcjellja e arkëtimit të të Hyrave Vetanake Komunale
- Kërkesat për Alokimin e të Hyrave Komunale në Thesarin Qendror
- Barazimi i të Hyrave Komunale me Thesarin Qendror
- Raportet mujore, tremujore dhe gjashtëmujore i të Hyrave Komunale dhe barazimi i tyre
- Barazimi dhe menaxhimi i të Hyrave vetanake Komunale sipas Planit vjetor të Aprovuar.

Zotimet

Janë kryer këto punë dhe detyra të punës në zbatim të zotimeve të Organizatës Buxhetore të Komunës së Istogut.

Janë bërë regjistrimet e zotim/ obligimeve dhe kërkesave të zotuar rreth 4,016 UOP-KZB , lëndëve në sistemin e “FreeBalance” deri date 31.12.2023.

Punët e kryera për Zotimet e lëndëve:

- Regjistrimi i zotim/obligimeve në sistemin FreeBalance për Programet Buxhetore të Komunës
- Punët profesionale, administrative dhe nxjerrja e raporteve për pozitën financiare të Komunës nga Thesari-FreeBalance
- Punët mbi sigurimin-kontrollin e nënshkrimeve të zyrtarëve përkatës në formularin UOP (CPO), KZB-Kërkesave Zotim për Blerje
Konsultimet me Zyren e Prokurimit dhe dorëzimi i Urdher Obligimeve UOP (CPO) dhe KZB-Kërkesave Zotim për Blerje në Zyren e Prokurimit për procedim të procedurave .

Shpenzimet

Gjatë periudhës 01.01.2023 deri më 31.12.2023, janë kryer të gjitha lëndët për procesim. Është bërë procesimi dhe futja në sistem SIMFK për 4,067 lëndë (në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës). Gjithashtu, janë skanuar 4,067 lëndë dhe janë bashkangjitur procesimit në SIMFK. Ka ndodhur edhe hapja e avanseve dhe mbyllja e avanseve për udhëtime zyrtare jashtë shtetit.

- Është bërë pranimi i të gjitha lëndëve nga Zyrtarët e Pranimit dhe zyrtarët tjerë që janë në lidhje me procesin e shpenzimeve nga Buxheti Komunal.
- Regjistrimi i Kuponave të shpenzimit pa Urdhër Blerje (UOP) dhe verifikimi i furnitorëve dhe llogarive bankare të të gjithë operatoreve ekonomik.
- Regjistrimi i Kuponave të shpenzimit të shpenzimeve me Urdhër Blerje që rrjedhin nga procesi i prokurimit (lëndët që kanë të bëjnë me procesin e prokurimit).
- Regjistrimi i Kuponave të shpenzimeve të Parave të Imëta (Rimbushja e Parave të imëta - Petty Cash-it)
- Regjistrimi i Kuponave të Shpenzimit për Shpenzimet dhe Meditjet e udhëtimeve zyrtare.
- Gjithashtu, janë nxjerrë dhe shkarkuar raporte ditore dhe mujore të alokimeve, shpenzimeve nga sistemi FreeBalance..

Pasuritë, Regjistrimi i pasurisë

Gjatë periudhës 01.01.2023 deri më 31.12.2023, janë kryer këto punë dhe detyra pune. Të gjitha lëndët, të cilat l përfunduar procesimin e pagesave në shuma totale me situacione prej 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6, janë procesuar në total të lëndë. Janë verifikuar dhe janë procesuar lëndët sipas kodeve ekonomike të shpenzimeve kapitale në SIM FreeBalance për vitin 2023. Janë procesuar gjithashtu lëndët e projekteve kapitale që kanë përfunduar dhe janë procesim nga Ministritë e linjës për vitin 2023.

PROJEKTET ME PARTICIPIM - 17517 BUXHETIMI-ISTOG

17517 BUXHETI - ISTOG	439,460.35
30 PASURITË JOFINANCIARE	439,460.35
50240 PROJEKTI ME PARTICIPIM TE KOMUNITETETIT ,MINISTRIVE TE LINJE	183,044.40
52269 NDERTIMI I RRUGEVE NE FSHATRA E KOMUNES SE ISTOGUT	17,440.00
53916 NDERTIMI I RRUGEVE NE LAGJEN OSMANAJ NE PREKALLE DHE NE LAGJ	14,000.00
54000 NDERTIMI I RRETHOJAVE NE VARREZAT E FSHATRAVE ZHAKOVE, TOMOC	39,216.20
54001 NDERTIMI DHE RENOVIMI I SHTEPIVE TE KULTURES NE FSHATRA DUB	45,600.00
54002 NDERTIMI I RRUGËVE NË FSHATRA E ORROBERDË, DOBRUSHË, SARADR	49,367.40
54003 NDERTIMI I RRUGËVE NE FSHATRA E DRAGOLEVC, ISTOG, ISTOG I POSHTËM	88,872.00

Sektori i Financave

Janë pranuar gjithsej 4067 lëndë nga ana e zyrtarit për shpenzime, të cilat janë kontrolluar, çertifikuar dhe janë aprovuar përmes sistemit të Fribalancit, pasi kompetencat kanë kaluar nëpër komunë, krahasuar me vitin 2022, numri i lëndëve është rritur. Gjatë kontrollit, disa lëndë janë vënë re të pa kompletuara dhe janë kthyer tek personat përgjegjës për tu plotësuar; këto janë 352 lëndë, të cilat, pas plotësimit, janë çertifikuar, aprovuar në sistem dhe janë arkivuar. Të gjitha këto lëndë janë regjistruar në një program të Excel për të ruajtur evidencën, dhe të njëjtat lëndë janë dorëzuar te zyrtarja për arkivim. Në protokollin e Drejtoratit tonë janë evidentuar 119 shkresa të ndryshme.

Me kërkesë të palëve për këtë periudhë, janë lëshuar gjithsej 169 Çertifikata të Gjendjes Ekonomike për qëllime të ndryshme (për botën e jashtme, nevoja personale, ndihma sociale, etj.). Sa i përket pagave, janë përcjellë në Ministrinë e Financave të gjitha ndryshimet për Janar-Dhjetor 2023, janë nënshkruar dhe dorëzuar listat e pagave për muajt Janar-Dhjetor 2023. Janë kalkuluar pagat e këshilltarëve të Asamblesë Komunale për periudhën Janar-Dhjetor 2023 dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Financave, si dhe është bërë kalkulimi i pagave të punëtorëve për shërbime të veçanta.

Të hyrat nga taksat dhe ngarkesat komunale, që janë inkasuar përmes Arkivës Komunale (pagesat deri në 10 €), kapin shumën prej 95,632 €.

Zyrtarja për arkivimin e lëndëve të Thesarit i ka arkivuar të gjitha lëndët origjinale që janë aprovuar si pagesa, gjithsej 4067 lëndë. Gjithashtu, nga zyrtarja për pranimin dhe protokolimin e fakturave, janë protokoluar gjithsej 4348 faktura.

Janë hapur gjithsej 49 avanse petty cash, të cilat janë me një shumë prej 9,930.00 €; gjithashtu, janë mbyllur të gjitha avanset e parave të imta.

RAPORTI VJETOR I PUNES PER TATIMIN NË PRONË PER VITIN 2023

"Sektori i Tatimeve në Pronë funksionon në kuadër të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, pranë Komunës së Istogut. Në kuadër të punëve dhe detyrave të punës gjatë periudhës nga 01.01.2023 deri më 31.12.2023, janë kryer këto punë dhe detyra të punës:

- **Lëshimi i faturave tatimore për vitin 2023** – për këtë vit kalendarik janë lëshuar gjithsej 33.563 fatura. Ato janë ndarë si më poshtë:
 - 11.349 fatura për objekte të paluajtshme, duke përfshirë objekte banimi, afarizmi, industriale dhe bujqësore;
 - 22.214 fatura për parcela, duke përfshirë parcela për shtëpi familjare, bujqësore, afariste, industriale dhe pyjore.

Aplikimi i tatimit në pasuri të paluajtshme - parcela, ka filluar nga viti 2019 për të gjitha parcelat e cekura më lart, përveç atyre bujqësore.

Shuma e faturuar - për këtë vit tatimor, shuma e faturuar gjithsejt është 680.117 €. Prej tyre, 474.683 € janë për objekte, ndërsa 205.434 € janë për parcela.

Planifikimi i inkasimit - Sipas Hyrjeve Vetanake Komunale për vitin 2023, është paraparë të inkasohen nga tatimi në pasuri, një shumë prej 437.787 €. Prej kësaj shume, 391.341 € vijnë nga objektet dhe 5.659 € vijnë nga parcelat.

Shpërndarja e faturave - Faturat tatimore për të gjithë tatimpaguesit e tatimit në pasuri janë shpërndarë përmes Postës së Kosovës, Njësia në Istog. Nga numri i përgjithshëm i faturave, shpërndarja bëhet vetëm për faturat që kanë një ngarkesë tatimore mbi 3 €, sipas Ligjit në fuqi.

Sipas Raportit mbi pranim-dorëzimin e dërgesave të faturave të tatimit në pronë për këtë vit, i datës 07.09.2023 nga PK –Njësia në Istog, gjendja e shpërndarjes së faturave është si më poshtë:

Nr.faturave	Shpërndarja	Mbetja	Përqindja
9.976	9.368	608	93,91 %

Mbetja prej 608 faturave të pashpërndara është rezultat i ndryshimeve të vendbanimit nga tatimpaguesit, si dhe adresave të pasakta, sipas shpjegimit të Përgjithshëm.

Ndryshimet në sistemin e tatimeve në pasuri - sipas shënimeve të mbledhura nga tereni dhe zyrtarët, për këtë vit janë kryer këto ndryshime në sistemin e tatimeve në pasuri:

- 484 objekte të reja janë regjistruar,
- 4.155 modifikime/rianketim të të dhënave të pronës janë kryer, duke tejkaluar kuotën prej 20%,
- 3.360 modifikime të të dhënave të tatimpaguesit

- **Ankesat** - gjatë afatit të paraqitjes së ankesave për këtë vit, janë pranuar gjithsej 12 ankesa me shkrim kundër faturave të tatimeve në pasuri dhe 6 kërkesa për korrigjim të destinimit të parcelave. Komisioni për verifikimin e ankesave dhe kërkesave ka kryer verifikimet e nevojshme për çdo rast. Të gjitha ankesat dhe kërkesat e tatimpaguesve janë aprovuar. Vendimet janë shkruar me shkrim dhe është kryer ndërhyrja në sistem për korrigjimin e ngarkesave tatimore për të gjitha rastet.

- **Vertetimet** - gjatë punës me palë, në këtë periudhë raportuese janë lëshuar rreth 6.617 vertetime nga sistemi i tatimeve në pasuri. Këto vertetime janë kërkuar nga palë të ndryshme për nevoja personale si transferimi i pasurisë, aplikim për tender, aplikim për subvencione nga bujqësia, aplikim për ndihmë sociale, etj.

- **Realizimi** – me qëllim të inkasimit të borxheve të tatimeve në pasuri, gjatë vitit janë përgatitur:

139 letrë-kujtesa,

8 kontrata janë hartuar për pagesë me keste të detyrimeve të tatimeve në pasuri.

- **Realizimi** - Gjatë vitit, inkasimi i tatimeve sipas muajve, dhe krahasimi me vitin e kaluar, është si më poshtë:

MUAJI	Viti 2022 ne €	Viti 2023 ne €
Janar	12.686,69	38.801,96
Shkurt	17.491,68	20.347,02
Mars	67.011,74	93.557,27
Prill	42.906,78	100.111,15

Maj	54.473,10	84.310,94
Qershor	19.519,70	24.149,71
Korrik	39.946,30	43.102,42
Gusht	65.945,08	75.574,97
Shtator	22.068,75	31.652,33
Tetor	23.386,08	31.478,81
Nentor	17.344,47	18.718,68
Dhjetor	40.038,39	20.437,81 dt.27.12.'23
Gjithsejt	422.818,76 ose 107%	582.243,07 ose 133%

Sipas Planifikimit për të Hyrat Vetanake Komunale, në emër të tatimeve në pasuri për vitin 2023 janë planifikuar të inkasohen 437.787,00 €. Deri në datën e raportimit, më 28.12.2023, janë inkasuar 582.243,07 €, ose 133% në krahasim me planifikimin.

DREJTORIA PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM

RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2023

1. Hyrje

Ky raport pasqyron aktivitetet, angazhimet dhe punët e kryera nga Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim (ne tekstin e më tutjeshëm - DEZH), gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023.

Objekti kryesor i DEZH për vitin 2023, është ngritja e ndikimit të tij në realizimin e projekteve të filluara dhe planifikimin e investimeve në projektet e reja, si dhe kryerja e punëve tjera varësisht nga detyrat dhe obligimet e stafit të kësaj Drejtorie. Në vijim, do të jepet raporti vjetor i punës për çdo sektor dhe zyre, që vepron në kuadër të DEZH.

Qëllimi

Njoftimi i anëtarëve të Komitetit për Politikë e Financa, Anëtarët e Kuvendit Komunal dhe të gjithë drejtorët e drejtorive me realizimin e investimeve të planifikuara, zhvillimin, shpenzimet dhe rezultatit e arritur në raport me buxhetin e aprovuar në fillim të vitit. Përmes këtyre raporteve sigurohen informacione të rëndësishme relevante për opinionin publik në lidhje me performancën fiskale, rezultatet e programeve, rrjedhën e parasë së gatshme etj.

1. Sektori për ekonomi

Sektori për Ekonomi është angazhuar në organizimin dhe koordinimin e punëve si vizita bizneseve dhe lëshimi i faturave për borxhet e viteve paraprake për ngarkesa vjetore të shërbimit me pije alkoolike për vitet 2008-2022, pasi që këto ngarkesa janë larguar në vitin 2023 me Rregulloren Komunale Nr. 4/2022.

Janë inkasuar 2,100 Euro nga ngarkesat vjetore të përdorimit dhe shërbimit me pije alkoolike. Borxhet e mbetura (të pa paguara) të bizneseve të cilat shërbejnë pije alkoolike për vitet 2008-2022 janë 7,940 Euro. Ndërsa borxhet e mbetura (të papaguara) të bizneseve për ngarkesa të afarizmit vjetor për vitet 2005-2012 janë 174,831.02 Euro.

Gjatë kësaj periudhe personeli i sektorit të ekonomisë në kuadër të Qendrës Komunale të Biznesi është angazhuar në kryerjen e këtyre punëve dhe detyrave:

Regjistrimi i bizneseve: 142

Shuarje të bizneseve: 15

Ndryshime në biznes: 75

Informatat e biznesit, Çertifikata e Llogo e re, Çertifikata ndërrim: 128

Vertetim i biznesit: 11

Këshillime për regjistrimin e bizneseve: 133

Këshillime për ndryshime në biznes: 117

Këshillime për shuarjet e biznesit: 37

Duhet të theksohet se me vendim të MTI-së, regjistrimi i bizneseve bëhet pa pagesë (taksa), ndërsa taksat tjera ende aplikohen (ndryshime në biznes, shtim i aktiviteteve, ndryshim i logotipit, etj)."

Sektori i zhvillimit

Sektori për zhvillim në vazhdimësi është duke bërë identifikimin e projekteve prioritare për propozime, si dhe po merr pjesë në aktivitetet rreth zhvillimeve rajonale, kontaktet dhe takimet me donatorët potencial, si dhe aplikimet për projekte zhvillimore.

Takimet e rregullta janë mbajtur me AZHR-në dhe Ministrinë për Zhvillim Rajonal si pjesë e projektit "Promovimi i politikave kombëtare të zhvillimit rajonal të balancuar në komunat e rajonit perëndimor të Kosovës", i cili projekt ka për qëllim të mbështes komunat e rajonit perëndimor në identifikimin e projekteve të përbashkëta si mjet për nxitjen e bashkëpunimit rajonal , projekte të cilat do të sigurojnë zhvillim socio-ekonomik të balancuar.

Tabela e projekteve kapitale të cilat janë në kryer për periudhën Janar - Dhjetor 2023

Tabela e projekteve kapitale për periudhën Janar – Dhjetor 2023

Nr	Emërtimi i projektit	Shuma e planifikuar	Shuma e kontraktuar	Burimet e financimit	Vërejtje
1	Ndërtimi i rrugëve në Gurrakoc	45,000	45,000	Buxheti komunal	Përfunduar
2	Ndërtimi i rrugëve në Vrellë	80,000	80,000	Buxheti komunal	Përfunduar
3	Ndërtimi i rrugëve në Banjë	40,000	40,000	Buxheti komunal	Përfunduar
4	Ndërtimi i rrugëve në Istog	80,000	80,000	Buxheti komunal	Përfunduar
5	Ndërtimi i rrugëve lokale në Kaliqan: Ukaj, Metaj	20,000	20,000	Buxheti komunal	Përfunduar
6	Ndërtimi i rrugëve në Prekallë (Bajram Hasani)	20,000	22,000	Buxheti komunal	Përfunduar
7	Ndërtimi i rrugës në Padalishtë lagja Imeraj	75,000	75,000	Buxheti komunal	Përfunduar
8	Ndërtimi i rrugës në Zhakovë lagja Hajrizaj	20,000	25,000	Buxheti komunal	Përfunduar
9	Ndërtimi i rrugëve në Shushicë "Kadri Hajdari" dhe "Bajram Keqa"	15,000	15,000	Buxheti komunal	Përfunduar
10	Ndërtimi i rrugës në Prekallë lagja Hoxhaj	10,000	10,000	Buxheti komunal	Përfunduar
11	Ndërtimi i rrugëve në Trubuhoc lagja Osmanaj, Bajraktari dhe Cetaj	75,000	75,000	Buxheti komunal	Përfunduar
12	Ndërtimi i rrugëve në Lubozhdë lagja Idrizaj dhe Pepaj	20,000	20,000	Buxheti komunal	Përfunduar
13	Ndërtimi i rrugës në Shushicë të Ulët lagja Nekaj	30,000	30,000	Buxheti komunal	Përfunduar
14	Ndërtimi i rrugëve në Cerrcë lagja Osmanaj, Rexhaj, Haskaj dhe Kurpalaj	40,000	40,000	Buxheti komunal	Përfunduar
15	Ndërtimi i rrugës në Muzhevinë-Istog lagja Bardhecaj dhe Arifaj	35,000	35,000	Buxheti komunal	Përfunduar
16	Ndërtimi i rrugës në Istog të Poshtëm "Kuvendi i Arbërit"	30,000	30,000	Buxheti komunal	Përfunduar
17	Ndërtimi i rrugës në "Tre Dëshmorët" lagja Cakutaj Kaliqan	20,000	20,000	Buxheti komunal	Përfunduar
18	Ndërtimi i rrugëve në Suriganë lagja Murtaaj, Mahmutaj, Zeqiraj, Veselaj dhe Seferaj	40,000	40,000	Buxheti komunal	Përfunduar
19	Ndërtimi i rrugëve në Baicë "Tahir Bajrami" dhe "Rexhë Kastrati"	30,000	30,000	Buxheti komunal	Përfunduar
20	Ndërtimi i rrugëve në Carrallukë lagja Xhemaj dhe Sylaj	30,000	30,000	Buxheti komunal	Përfunduar
21	Ndërtimi i rrugëve në Rakosh "Hajriz Metaj"	20,000	20,000	Buxheti komunal	Përfunduar

22	Ndërtimi i rrugës në Orroberdë lagja Muzlijaj dhe Maksutaj	30,000	30,000	Buxheti komunal	Përfunduar
23	Ndërtimi i rrugëve në Prigodë lagja Gashi, Ramqaj dhe Dreshaj	45,000	45,000	Buxheti komunal	Përfunduar
24	Ndërtimi i rrugëve në Kërrninë të Epërme dhe të Ulët	40,000	40,000	Buxheti komunal	Përfunduar

Në bashkëpunim me organizatën “Preda Plus” janë mbajtur trajnime dhe punëtori për ngritje të kapaciteteve për menaxhimin e skemës e granteve, ku si pjesë e kësaj skeme është realizuar projekti i themelimit të Qendrës për Angazhim të Komuniteteve. Pjesë e kësaj skeme është edhe ndarja e granteve për 11 (njëmbëdhjetë) start-up biznese, e cila është realizuar në bashkëfinancim me komunën.

Në bashkëpunim me organizatën “Germin” janë mbajtur punëtori për Projekte Investive në kuadër të projektit “Mardi” dhe është hartuar projekt propozimi me qëllim mbështetjen me grant në fushën e zhvillimit të turizmit, në bashkëpunim me komunitetin e biznesit nga Diaspora.

Nga sektori për Zhvillim është realizuar projekti i forcimit të ekonomisë rurale dhe krijimi i mundësive të gjenerimit të të ardhurave, i mbështetur nga Komuna dhe Islamic Relief Kosova, nga i cili kanë përfutur panele solare 152 fermerë.

Përveç tjerash, sektori për zhvillim është angazhuar edhe në komisionet për vlerësimet e ofertave të projekteve kapitale.

Bashkupime i Komunës dhe Ministrisë së Infrastrukturës (projekte dy-vjeçare 2023 – 2024), si:

1. Asfaltimi i rrugës Istog – “Mehmet Ejupi”
2. Asfaltimi i rrugës Saradran- Kashicë –Dobrushë ” Rusolia dhe Mesha Selimović” ;
3. Asfaltimi i rrugës Dobrushë – “Jusuf Kovaçević”
4. Asfaltimi i rrugëve në Istog ;

Kanë vazhduar takimet e rregullta midis AZHR Perëndim dhe Veri dhe Komunave Istog dhe Zubin Potok me qëllim të përgatitjeve për të aplikuar në IPA fondet për zhvillim. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2018 janë realizuar disa takime me OJQ-të vendore, lidhur me mundësinë e bashkëpunimit për projekte kapitale dhe zhvillimore, e të cilat mbështeten nga donatorë të jashtëm (kryesisht Komisioni Evropian, USAID, GIZ-I, etj). Sektori për zhvillim po ashtu është duke punuar në përpilimin e projekt propozimeve me qëllim që të jemi të përgatitur në momentin që shpallen thirrje për aplikim në IPA fonde e po ashtu nga donatorët e tjerë të mundshëm, si për bashkëpunim ndërkufitar ashtu edhe për bashkëpunim të brendshëm në mes të Komunës, OJQ, dhe Donatoreve me qëllim përmirësimin dhe zhvillimin e Komune. Në vazhdimësi po mbahen takimet e rregullta midis AZHR dhe Këshillit rajonal për turizëm, që synon promovimin e turizmit në rajon dhe fuqizimin e sektorit për turizëm. Përveç tjerash, sektori për zhvillim është angazhuar edhe në komisionet për vlerësimet e ofertave të projekteve kapitale. Janë pranuar dhe shqyrtuar kërkesa të ndryshme të drejtuara Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim.

DREJTORIA PËR KADASTËR, PRONË DHE GJEODEZI

RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2023

Gjatë vitit 2023 zyrtarët në Drejtorinë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi janë ngarkuar në kryerjen e punëve sipas përshkrimit të vendeve të punës, me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më cilësore për qytetarët e Komunës së Istogut.

Në Drejtorinë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi gjatë viti 2023 janë shqyrtuar gjithsej rreth 2500 Lëndë/Kërkesa të natyrave të ndryshme p.sh. Regjistrim Pronësie, Shitblerje, Trashëgimi, Historiate, Hipoteka etj.

Poashtu gjatë vitit 2023 janë realizuar rreth 85 dalje në teren për matje të ndryshme për nevoja të Komunës, por edhe për nevoja të institucioneve të tjera me të cilat bashkëpunojmë ngushtë siç janë Policia e Kosovë dhe Gjykata.

Gjatë vitit 2023 kemi vazhduar me shërbime për qytetarë ku gjatë gjithë vitit janë lëshuar 6223 Çertifikata të Pronësisë dhe Kopje të Planit, si dhe në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës kemi filluar nga ky vit për herë të parë të lëshojmë edhe Çertifikata të Pronësisë Online përmes platformës E-Kosova si dhe gjatë këtij viti kemi filluar për herë të parë poashtu njoftimin e palëve përmes numrit të telefonit me SMS lidhur me ecurinë e Lëndës.

Në Sektorin e Pronës gjatë vitit 2023 janë pranuar dhe shqyrtuar gjithsejtë 62 kërkesa. Ky sektorë ka trajtuar kërkesa të ndryshme ku pjesë e këtyre kërkesave kanë qenë edhe këmbimet e pronave të ndryshme për realizimin e interesit publik. Poashtu edhe gjatë këtij viti kemi vazhduar me mbledhjen e borxheve të vjetra për shfrytëzuesit e pronave komunale duke bërë njoftime të vazhdueshme për subjektet të cilat i shfrytëzojnë këto prona si dhe duke ndërmarrë edhe masa të tjera ligjore për palët të cilët nuk i janë përgjigjur njoftimeve të cilat i 'u janë dërguar nga Drejtoria.

Në periudhën Janar-Dhjetor 2023 nga shërbimet e ofruara në Drejtorinë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi dhe nga inkasimi i borxheve kemi realizuar shifrën prej 239,538.00 të hyra.

Në vitin 2023 kemi filluar me Projektin e Dixhitalizimit të Elaboratit Kadastral, i cili është projekt 3 vjeçar që do të vazhdojë edhe në 2 vitet e ardhshme dhe përfshinë: grumbullimin dhe verifikimin e dokumentacionit(plane, skica, fletore takeometrike, manual), korrigjimin e rrjetës gjeodezike, dixhitalizimin e të dhënave kadastrale, distribuimin e të dhënave etj.

Me përfundimin e këtij projekti do të mundësohet marrja e shërbimeve gjeodezike në mënyrë dixhitale që nënkupton që do të përshpejtohen shërbimet si dhe do të mundësohet ruajtja e të gjitha dokumenteve të vjetra të cilat i posedon Arkivi i Drejtorisë duke u skanuar në mënyrë profesionale dhe më pas do të përdoren vetëm materialet e skanuara dhe jo ato fizike.

Bashkangjitur me këtë raport gjeni edhe të dhënat statistikore të nxjerra nga sistemi SIKTK-T dhe faqja e Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS
RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2023

Në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mjedis, gjatë vitit 2023, kujdes i veçantë i është kushtuar përfundimit të lëndëve të vjetra për leje ndërtimi dhe monitorimi i respektimit të afateve ligjore. Kanë vazhduar takimet e shpeshta brenda drejtorisë, duke tentuar që të eliminohen pengesat në shqyrtim të lëndëve. Vonesat në shqyrtim janë evidentuar në lëndët që janë në trajtim ende pa arritur zgjidhjet urbane, andaj është aprovuar zgjidhje urbane që do t'u ndihmojë kërkuuesve që të konsultohen për zgjidhje urbane paraprakisht kërkesës për kushte ndërtimore. Është punuar në atë që zgjidhjet urbane të sigurojnë qëndrueshmëri të zhvillimit, si proces para kushteve të ndërtimit për ndërtesat e kategorisë I (një) dhe II (dy), kështu që gjatë kësaj preudhe të vitit 2023 rendësi të veçantë i kemi kushtuar dokumentit multi-sektorial Hartes Zonale e në të cilin edhe është aprovuar në asamble me dt.28.12.2023

Gjatë kësaj periudhe janë përfunduar lëndët e vjetra me dokumente konkrete-kushte ndërtimi dhe leje ndërtimi. Për më tepër, vonesa paraqesin procedurat për legjitimimin e marrëveshjeve të ndryshme pronësore si bashkimi i parcelave ose shpronësimi, si dhe ndërrimi i destinimit të tokës, duke mos lënë anash edhe vonesat e palëve për të marrë informimet për plotësim dokumentacioni.

Spektori i urbanizmit

Gjatë kësaj peridhe janar – dhjetor të vitit 2023, është evidentuar numër mesatar i kërkesave pamëvarësisht Krizës globale, andaj dhe intensiteti i punës në këtë sektor ka vazhduar puna normalisht në zgjidhje të lëndëve. Janë evidentuar mbi 540 kërkesa hyrëse dhe 10 kërkesa dalëse, prej të cilave 143 kërkesa për kushte dhe leje ndërtimi. Janë trajtuar 143 kërkesa sa janë pranuar për Kushte dhe Leje ndërtimore, nga të cilat 2 ndërtesë e banimit shumëkatëshe kat II, ndërtesa afariste dhe prodhuese 12 kategoria II, kurse 84 ndërtesa të banimit individual. Gjithashtu 16 ndërtesa për zhvillim ekonomik dhe 6 ndërtesa tregtare-afariste janë procesuar dhe janë pajisur me Leje ndërtimore. Sikur edhe është paraqitur në tabelë, gjatë këtij viti janë përcaktuar kushte-pelqime ndërtimi për 198 kërkesa, derisa 133 kërkesa janë përfunduar me pëlqime të ndryshme, pëlqime parimore paraprake sa i përket pronës dhe të ngjashme. Janë në procesim edhe 10 kërkesa.

Koha	Leje ndërtimi	Kushte ndërtimi	Certifikatë përdorimi	Pelqime për ndërtim	Pëlqimet	Përgjigje (refuzuara)
Janar	1	1	2 1 4 7	27	133	84
Shkurt	6	0				
Mars	17	3				
Prill	9	0				
Maj	19	1				
Qershor	17	3				

Korrik	12	0	1			
Gusht	5	1				
shtator	9	3				
Tetor	24	4				
Nëntor	5	0				
Dhjetor	3	0	1			
Gjithsej	127	16	16	27	133	84

Drejtoria realizon të hyra nga taksat për leje të ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës dhe nga taksa administrative për leje të ndërtimit, bazuar në “Rregullore mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 04/23. Në të hyra kanë ndikuar edhe taksa për Shëndrrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore.

Në këtë periudhë raportuese janë realizuar këto projekte:

1. Rregullimi i trotuareve në Istog(zona urbane),
2. Ndërtimi i parkut pushues dhe rekreativ në Gjuraçok për të moshuarit
3. Ndërtimi i Shtegut ‘Rënza’ për çiklizem dhe ecje,
4. Ndërtimi i infrastrukturës – ujësjellësi, gjelbrimi dhendriçimi për qendrën urbane të Istogut,
5. Mirëmbajtja e adresave ,
6. Furnizimi me shtëpiza në sheshin “Ibrahim Rugova” .

Është vazhduar puna në plotësimin e informatave në sistemin e monitorimit të procedurës për marrjen e lejes së ndërtimit (Permit tracking System), ku paraqiten informatat për qytetarë, si dhe është punuar në informimin e zyrtarëve për lëndët të cilave u ofrohet afati ligjor i shqyrtimit. Përveç trajtimit të lëndëve, zyrtarët e sektorit kanë qenë të angazhuar edhe me aktivitete të tjera përcjellëse, si mbikëqyrje të projekteve që investohen nga Komuna, si dhe mbikëqyrje të planeve urbane.

Duhet theksuar se këtë vit është krijuar dhe Zyra për marrëdhënie me publikun, në mënyrë të organizimit të ngjarjeve të ndryshme brenda drejtorisë, takimet me institucione dhe palë të ndryshme, si dhe prononcime mediatike të cilat kanë të bëjnë me DPUM-në.

Aktivitetet e planifikuara:

☐ Zbatimi i Bazës ligjore për planifikim e ndërtim-shqyrtimit të lëndëve me një dinamikë të pranueshme, duke respektuar afatet ligjore;

- Hartimi i dokumenteve me rregullativa që lehtësojnë funksionimin e Sektorit;
- Vlerësimi i lëndëve nga Planerët urban, si dhe marrja e vendimeve për lëndët ku ka dilema në zgjidhje;
 - ☐ Përgatitjet që të integrohen të dhënat e lejeve të ndërtimit në Sistemin vrojtues;
 - ☐ Përpunimi i faqes së Komunës sa i përket Drejtorisë;
 - ☐ Përmirësimi i shërbimit të informimit të qytetarëve;
 - ☐ Hartimi i zgjidhjeve urbane dhe prezantimi në drejtori dhe në publik;
 - ☐ Avancimi i sistemit të vrojtimit të lejeve
 - ☐ Informimi i qytetarëve për çfarëdo informate që u intereson sa i përket Urbanizmit;
 - ☐ Takimet me palë për identifikimin e problemeve, adresimin dhe shqyrtimin e tyre në bazë të legjislacionit në fuqi;
 - ☐ Identifikimi i pengesave në zbatim të planeve;
 - ☐ Takimet me qytetarët për diskutimet për Hartën Zonale pas Aprovimit në asamble,
 - ☐ Kryerja e lëndëve në bazë të kërkesave të palëve në afat;
 - ☐ Përgatitja e detyrave projektuese;
 - ☐ Mbikëqyrja e kontratave të të gjitha llojeve;
 - ☐ Finalizimi i rregulloreve të filluara;
 - ☐ Këshillimi i drejtorit dhe sektorëve tjerë për çështjet e ndërtimit;
 - ☐ Identifikimi dhe regjistrimi i objekteve – certifikatë përdorimi, të ndërtuara me leje;
 - ☐ Pranimi i lëndëve dedikuar vetëm për Sektorin e legalizimit;
 - ☐ Fillimi i trajtimit të lëndëve të legalizimit;
 - ☐ Hartimi i databazës elektronike të brendshme për kërkesat për legalizim, ankesa, kërkesa të ndryshme dhe arkivimit (kontroll i brendshëm i procesit të lëndëve, sistem qendror);
 - ☐ Fushata informuese dhe sensibilizuese;
 - ☐ Pranimi i aplikacioneve të reja për legalizim;
 - ☐ Legalizimi i objekteve të dy kategorive;
 - ☐ Hartimi i përmbajtjes minimale (sqarimi) të dokumentacionit për aplikim për legalizim;
 - ☐ Hartimi i draftit të parë për Planin lokal të veprimit në mjedis;
 - ☐ Rritja e sipërfaqeve gjelbëruese dhe mbjellja e drurëve, duke përfshirë disa parqe të planifikuara më parë;
 - ☐ Fushata vetëdijesuese nëpër institucionet shkollore në lidhje me shumë aspekte mjedisore për qëllim vetëdijesimi;
 - ☐ Shtimi i sipërfaqeve gjelbëruese në pjesët e ndryshme të qytetit;
 - ☐ Mbajllja e drurëve dekorativë;
 - ☐ Shënimi i aktiviteteve mjedisore, si: 22 Prilli - Dita botërore e Tokës, 5 Dhjetori - Dita Botërore e Mjedisit, si dhe aktivitet rreth organizimit të Javës për ndryshime klimatike, në bashkëpunim me REC dhe MMPHI;
 - ☐ Një ndër aktivitetet e planifikuara më të rëndësishme për vitin 2023, ka qenë Memorandumi i bashkëpunimit të Agjensionit kadastral për mirëmbajtje të adresave dhe vendosja e shenjave të emërtimëve

të rrugëve publike në komunën e Istogut.

□ Përgaditja e rregullores për cilësi të ajrit në komunën tonë Memorandum mes Komunës dhe Let's Do It Peja.

□ Këtë vit ka qenë e planifikuar që përmes një analize më të thellë të lëndëve, ligjeve në fuqi dhe përmes një pune të palodhshme, të arrihet më shumë në ngritjen profesionale të nëpunësve të Sektorit të shërbimeve të përbashkëta, në mënyrë që të evitohen gabimet e kaluara në përpilimin e vendimeve të këtij organi.

Legalizimi

Në këtë sektor shqyrtohen lendet të cilat janë për Legalizim pasi që ka hyr në fuqi Ligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje kërkesa të pranuar prej shtatorit- 2023 janë gjithësej 21.

Është duke u punuar me intensitet të shtuar për përfundimin e objekteve të kat I dhe janë vendos nr. i caktuar i lëndëve. Të miratuara janë 105, kurse në pritje janë 25,

Sa i përket objekteve të kat II janë inspektu 4 objekte nga zyrtarët dhe presim raportin përfundimtar për miratim.

Trajnimi i stafit sipas konditave dhe standardeve më të reja, të cilat do të aplikohen në përdorimin e programit të caktuar dhe të avancuar për aplikim trajtim, të kërkesave në trajtim të ndërtimeve pa leje, në bashkëpunim me MMPHI-në dhe Memorandumi i programit mbështetës të USAID-it.

Aktivitetet e planifikuara për vitin 2023:

- Zbatimi i rregullativës ligjore në fuqi dhe afateve ligjore të përcaktuara në procedurën e shqyrtimit dhe të vendosjes për kërkesat për ndërtimet pa leje, të përfunduara dhe substancialisht të përfunduara, të kategorisë I dhe të kategorisë II, të cilat janë shtëpi, ndërtimet pa leje të përfunduara dhe substancialisht të përfunduara, të kategorisë II, të cilat nuk janë shtëpi.
- Ndërtimet pa leje të papërfunduara të kategorisë I dhe të kategorisë II, të cilat janë shtëpi, dhe ndërtimet pa leje të papërfunduara të kategorisë II, të cilat nuk janë shtëpi.
- Caktim të kushteve ndërtimore për dhënien e Lejes për legalizim dhe përfundim të ndërtimit, të kërkesave tjera;
- Zbatimi i rregullave të vendosura dhe qëndrimeve të marra në takimet e mbajtura si në aspektin e eliminimit dhe procedurave të panevojshme, po ashtu edhe në reduktimin e kohës së nevojshme për përfundimin e atij procesi;
- Riorganizimi e punës në Zyrën shërbyese, One Stop Shop, e cila duhet të funksionon në kuadër të Sektorit të urbanizmit dhe legalizimit të kësaj drejtorie;

Mjedisi

- - Gjatë vitit 2023 nga Sektori për Mbrojtje të Mjedisit janë realizuar këto detyra:
- Gjatë këtij viti kalendarik 2023 janë parashtruar 22 kërkesa nga qytetaret
- 16 kërkesa për Leje Mjedisore Komunale

- 4 kërkesa mjedisore
- 2 kërkesa për Pëlqime të pastrimit ,
- Janë lëshuar 16 Vendime për LMK
- 16 procesverbale të hartuara në teren
- Një kërkesë për LMK është pezulluar
- 4 Njoftime nga Sektori i Mjedisit
- 2 Pëlqime për pastrim.
- Jemi fazën përfundimtare të Hartimit të Planit Lokal të cilësisë së ajrit. Gjate hartimit të këtij Planit janë kryer këto aktivitete :
- Aksion gjelbërimi -mbjellja 25 fidanëve në parkun e qytetit Istog
- Takim me komunitete ,ligjërata edukuese me nxënës ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit
- Aksione simbolike në shkollë pastrim të mjedisit ,piktura me moton: "Ta ruajmë mjedisin dhe shëndetin".
- Takime në ngritjen e kapaciteteve për mortje jen e mjedisit të bizneseve të cilat kanë ndikim në mjedis, gurëthyesve, furrave të bukës ,restoranteve etj
- Monitorimin e cilësisë së ajrit në qytetin e Istogut
- Duhet theksuar Bashkëpunimin me Qendrën Rajonale të Mjedisit, REC- Zyra në Kosovë ku jemi pjesë në Projektin CRESIDA që ka objektiv Vlerësimin i Ujëmbledhësve për Ballkanin Perëndimor".
- Ky projekt po zbatohet në bashkëpunim me zyrat e REC në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoni Veriore, Mal të Zi dhe Kosovë. Në si komune kemi përshkruar Gjendja e lumit Istogut si prurje (degë) e Lumit Drin
- Jemi përgjigjur thirrjes nga Presidenca e Republikës së Kosovës për mbjelljen drunjtëve të iniciativës "Kosova e Gjelbër " për territorin e komunës së Istogut . Kemi përcaktuar të gjitha zonat përgjatë rrugëve dhe trotuareve për mbjelljen e fidanëve duke përfshi edhe disa nga pronat publike dhe zonat e domosdoshme për gjelbërim.
- Po ashtu me një Pilot projekt të financuar JICA Japonezë të projektit ECO-DRR kemi mbjellë 250 fidanë të llojit Bli , Pishë e zezë dhe Bredh i bardh që kanë një ndikim për zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë e ekosistemit
- Kemi qenë pjesëmarrës në disa Komisione për probleme të natyrës mjedisore, në bashkëpunim me Inspektorët Komunal dhe të Drejtorive Komunale si Drejtorinë për Bujqësi , Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport dhe atë për Zhvillim Ekonomik , të gjitha këto në bazë të detyrës zyrtare si :
- Monitorim i mjedisit në institucionet shkollore
- Muaj Prill muaj i aksionit për pastrim
- Mbjellja e drunjeve dekorativ në oborret e shkollave
- Takimi me nxënës , bizneseve që kanë ndikim në mjedis për ngritjen e Kapaciteteve për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit, si dhe
- Realizimin e detyrave dhe përgjegjësi duke filluar nga Kryetari, Drejtori i DPUM si dhe Drejtorive të tjera

- Bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës ka qenë në nivel për plotësimin e formularëve të ndryshëm dhe ofrimin e të dhënave nga sektori mjedisor duke përfshirë ajrin, ujin dhe token.
- Ne kuadër të detyrës nga Drejtoria për Inspektion , Inspektori i mjedisit janë parashtruar 13 kërkesa- ankesa të ndryshme që kemi hartuar 7 proces verbale prej tyre 4 përgjigjeje në kërkesa . Po ashtu kemi qen pjesë ekipore në teren së bashku me inspektorë nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës .
- Po ashtu kemi i qenë pjesëmarrës në disa Komisione për probleme të natyrës mjedisore, angazhime dhe Punëtori të Ekipeve Komunale AZHR –Perëndim.

Lista e Lejeve Mjedisore gjatë Vitit 2023

Nr.R	Nr Lendes , d E kërkesës	Emri dhe Mbiemri	Veprimtaria –Z.K	Data e lëshimit	Shuma e pagesës
01	11.351.9154 03.03.2023	Riva Berisha	Nd. Ob af.banesor S+P+3K+KT	10.03.2023	604 €
02	11.351.10022 10.03.2023	Abdulla Llapi	Nd, Shtallës për viqa Z. kat. Istog	22.03.2023	57.60 €
03.	11.351.967. 07.03.2023	Bajram Nimanaj	Nd. Shtallës për lopë Z.kat Shushicë	23.03.2023	92 €
04.	11.351.12069 24.03.2023	Lulzim Sadrijaj	Nd. Ob-Depo për ruajtjen e fton Z.K. Dubravë	05.04.2023	132 €
05.	11.351.11699 22.03.2023	N.H.T Freskia-A.D	Nd. Ob. Afarist –Aneks S+P+1K Z.K. Istog	06.04.2023	390 €
06.	11.351.13121 03.04.2023	Fidan Ibrahimaj	Renovim dhe Ndërtim të shatall për lopë Z.K. Veriq	07.04.2023	92 €
07.	11.351.15789 25.04.2023	Adnan Maxharraj	Ndërtimi i shtallës për dele Z.K.Studenicë	04.05.2023	142€
08.	11.351.18295 11.05.2023	IBOS IDJ SH.P.K.	Ndërtimi i Objektit afarist banes P+5K Z.K Istog	24.05.2023	2058€
09.	11.351.23177 14.06.2023	Enver Gashi	Rindërtimi i katit 4 dhe 5 i objektit banesor	03.07./2023	661€
10.	11.351.39612 19.09.2023	Sami Rugova	Ndërtimi i objektit të banimit individual	10.10.2023	692€
11.	11.351.42998 12.10.2023	Artins Grup SH.P.K.	Ndërtimi i objektit Afarist Banes B+S+P+5K	02.11.2023	7855€
12.	11.351.44085 23.10.2023	Smajl Buleshkaj	Ndërtimi i objektit të banimit me afarizëm P+1K	02.11.2023	429€
13.	11.351.44819 30.10.2023	NEËCOTROFTA L.L.C.	Ndërtimi i Pishinës së brendshme	07.11.2023	919€
14.	11.351.47683 20.11.2023	Afrim Abazi	Ndërtimi i objektit të banimit me afarizëm P+4K	30.11.2023	622€
15.	11.351.50220 13.12.2023	Lika Desingn SH.P.K.	Ndërtimi i Objektit Depo Bujqë (P+0)		220€
16.	11.351.48871 01.12.2023	Real Invest SH.P.K.	Ndërtimi i Objektit banesor me Afarizëm B+P+6K		3645€

	Shërbimet brenda Sektorëve të DPUM	Shuma në €
1	Lejet ndërtimore	93,095.40€
2	Shëndrrimi i tokës bujqësore në atë ndërtimore	29,035.50€
3	Lejet për legalizim	15,356.50€
4	Lejet për mjedis	18,610.60€
5	Pelqime, vërtetime dhe kërkesa të ndryshme	1,939.00€
	TOTALI	158,037.00€

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT
RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2023

Drejtoria Komunale e Arsimit, kryen detyrat dhe obligimet në përputhje me Ligjin për Arsim parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, Ligjin Për Arsim në Komunitet të Republikës së Kosovës nr.03/L-068, Ligjin për Arsimin dhe aftësimin Profesional nr.02 L-42, Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin e të rriturve nr. 02/L-24, Ligjin për Arsimin Parashkollor nga MASHT, dhe UA të MASHTT-it që përcaktojnë përgjegjësit e Komunitetit për organizimin e procesit edukativo-arsimor në të gjitha nivelet si dhe aktet tjera komunale.

Drejtoria Komunale e Arsimit në Istog, bazuar në vendimet dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës ka ndërmarr të gjitha masat që viti shkollor-mësimor 2023/24 të fillojë sipas normave të përcaktuara në këto vendime dhe udhëzime,

Viti shkollor, ka filluar me 1 shtator 2023, dhe do të përfundojë me 31 Gusht 2024, kjo e paraparë me UA nr 21/2023, për kalendarin e vitit shkollor 2023/24

Sipas këtij udhëzimi të miratuar nga MASHTI gjysmë vjetori i parë shkollor do të fillojë me 1 shtator 2023 dhe do të përfundojë me 12 janar 2024, gjysmëvjetori i dytë fillon me 24 janar 2024 dhe përfundon

- -Klasat e 12-ta me 16 maj 2024,
- -klasat e 9-ta ,10-ta dhe 11-ta, me 06 qershor 2024,
- -klasa parafilllore dhe klasat nga 1-8-ta, më 24 qershor 2024.kurse
- -Institucionet e kopshteve do ta përfundojnë më 31 korrik 2024.

Përveq mësimin të rregullt nxënësit do të ndjekin edhe mësimin praktik dhe praktikën profesionale
Pushimet: Viti shkollor do të ketë pushimin:

- vjeshtor që fillon 01 nëntor dhe përfundon me 03 nëntor 2024,
- pushimin dimëror që fillon me 15 janar 2024 dhe përfundon me 23 janar 2024, dhe
- pushimin pranveror që fillon me 8 prill 2024 dhe përfundon me 12 prill 2024

Organizimi i punës është udhëhequr dhe menaxhuar nga DKA-ja, drejtorët e shkollave dhe stafi profesional, prindër dhe nxënës, përmes organeve udhëheqëse të shkollës në bashkëpunim të vazhdueshëm me akterët tjerë si MASHTI dhe Sektorin e Inspektoratit për Arsim gjithnjë duke respektuar Ligjin e Arsimit Parauniversitar si dhe udhëzimet e lartëcekura.

Zhvillimi profesional i mësimdhënësve gjatë kësaj periudhe ka vazhduar bazuar në ofertën e MASHTI-t, ofertuesve tjerë dhe në të gjitha rastet është menaxhuar mirë nga DKA-ja dhe adresimi ka qenë aspekti profesional i mësimdhënësve.

Në kuadër të trajnimit Shkathësitë për adoleshencë nga LIONS-Klub janë trajnuar mbi 150 mësimdhënës

Në përfundim të vitin shkollor 2022/23 numri i nxënësve që iu nënshtruan:

- Testin e arritshmërisë është 527 nxënës, kurse
- Testin e matures 416 nxënës.
- Në klasën e parë deri në kohën e raportimit janë regjistruar 522 nxënës.
- Në klasën e 10-të në Gjimnazin Haxhi Zeka të regjistruar kemi: 234 nxënës në dy drejtime, kurse
- Në SHMT Mithat Frasheri- klasa e 10 janë regjistruar 208 nxënës në 5 drejtime.

Drejtoria Komunale e Arsimit bashkë me shkollat është e angazhuar në procesin e parandalimit braktisjes dhe mos regjistrimit të fëmijëve në shkolla.

Ne kemi analizuar nevojat dhe ju kemi përgjigjur kërkesave për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe kjo ka qenë kompetencë e ekipit komunal për vlerësim pedagogjik i cili ju është përgjigjur çdo kërkesë që është iniciuar duke vlerësuar dhe analizuar çështjet me rekomandime për kompetentet.

Drejtoria Komunale e Arsimit ka vazhduar me organizimin i trajnimeve me qëllim të ngritjes së kapaciteteve në mësimdhënie dhe në të nxënës.

Angazhimi në ngritjen e cilësisë

Drejtoria Komunale e Arsimit ka organizuar dhe udhëhequr procesin e vlerësimit kolegjial në 5 shkolla të komunës sonë, ky vlerësim është bërë nga ekipi komunal për vlerësim kolegut i bazuar në projektin e arritur nga MASHTI dhe organizata EU KosEd me vendim nr. 129/2023 i datës 06.03.2023.

Bazuar në këtë marrëveshje DKA-ja ka formuar ekipin komunal prej 21 anëtarësh të përbër nga drejtor shkollash, mësimdhënës nga të gjitha fushat kurrikulare, psikolog e pedagog dhe për 5 javë rresht kemi bërë vëzhgim kolegjial në shkollat fillore dhe te mesme të ulëta, si:

- Shfmu "Bajram Curri" në Istog
- Shfmu "Hysni Zajmi" në Vrellë
- Shfmu "Martin Camaj" Në Gurrakoc
- Shfmu "Trepça" në Banjë dhe
- Shfmu "Tre Dëshmorët e Shkollës Shqipe" në Uçë

Vlerësimi kolegut ka filluar me datë 13 nëntor 2023 dhe ka përfunduar me datë 22 dhjetor 2023, çdo shkollë ekipi ka qendruar 5 ditë rresht i fokusuar në 5 fusha të vlerësimit, si: Planifikimi dhe menaxhimi, kultura dhe mjedisi, zhvillimi profesional i mësimitdhënësve, Mësimdhënia të nxënësve dhe Vlerësimi, performanca e nxënësve, që për qëllim kishte identifikimin e pikave të forta dhe të dobëta, shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira në mësimdhënie/nxënie, gjegjësisht ngritja e cilësisë në mësimdhënie/nxënie në shkollat e komunës sonë.

Këto organizime dhe monitorime janë bërë në bazë të obligimeve që dalin nga politikat qendrore e lokale të bazuara në planet, strategjitë dhe protokollet e aprovuara me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së shkollës në kontest të rritjes së cilësisë në arsim.

Në bazë të kontratës në mes të Komunës së Istogut dhe QTH-ë Qendra Terapeutike e HEMERER “SHERBIME PROFESIONALE PËR TË RRIUR DHE FËMIJË ME NEVOJA TË VEÇANTA”DKA-ja ka realizuar shërbime logopedike dhe për tre muaj punë intensive Ekipi I Qendres Terapeutike Heimerer për fazën e parë të projektit përfundoj vlerësimin e fëmijëve në të gjitha kopshtet dhe institucionet parashkollore.

Vlerësimi u bë në 5 Kopshte dhe 16 Institucione Parashkollore.

Spektori administrativ sipas planifikimit dhe dinamikës së punës për periudhën raportuese ka realizuar e që konsiderohet si me të rëndësishme:

- Pranimi dhe shqyrtimi dhe vendosja me mbi 600 lëndëve të natyrave të ndryshme që e karakterizojnë drejtorin e arsimit.
- Janë lëshuar mbi 200 përgjigje në kërkesat e palëve
- Janë lëshuar 11 vendime për pushim të lehonisë
- Janë lëshuar 10 vendimeve për pensionim të stafit arsimor
- Janë lëshuar 120 vendimi për pagës të mbi normës
- Shpalljen e 8 konkurseve për pranim të stafit arsimor
- Janë lëshuar 150 kontrata të punës për mësimdhënës dhe punëtor teknik të të gjitha niveleve të cilët janë pranuar sipas procedurave të rregullta ligjore.
- Shpallja e konkursit për ndarjen e bursave Komunale
- Shqyrtimi i kërkesave për qasje në dokumente zyrtare.
- Shqyrtimi i ankesave të drejtuara këtij drejtorati nga natyrat të ndryshme

Projektet kapitale

Drejtoria Komunale e Arsimit ka pregaditur të gjitha dokumentet dhe ka derguar në zyre të prokurimit për procedurën e tenderimit. Këto projekte :

- Shërbime Profesionale për të rritur dhe fëmijë me nevoja të veçanta,
- Dezinfektimi,dezinsektimi dhe Deratizimi i IP,
- Material për mirëmbajtjen e shkollave,
- Transporti i nxënësve në distanca mbi 4 km, që kap shumën 80.000 euro
- Subvencionimi I prindërve me nevojë për shpenzime të udhëtimit për fëmijët/nxënësit
- Rekrutimi I mbi 25 punëtorëve të rinj në shërbim të shkollave
- Organizimi dhe mbajtja e garave të diturisë dhe të shkathtësive në nivel komunal e shtetëror

- Furnizimi i institucioneve shkollore dhe IP me lëndë djegëse-dru dhe pelet.
- Blerja, furnizimi dhe montimi i perdeve shiritore në IP “Gëzimi Ynë”, “Shpresa Jonë” dhe shkollat “Tre dëshmorët” dhe “Fan Noli”,
- Ndërtimi i infrastruktures së jashtme, gropes septike dhe poligonit sportiv në Sh.f.Martin Camaj – Serbobran ,
- “Ndërtimi i një pjese të rrethojës mbi murin e sh.f.m.u Tre Dëshmoret Uçë dhe rrethojës në Shfmu Ndre Mjeda Rakosh”,
- Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme, fasadimi, ndërrimi i dyerve dhe dritarëve në shkollën “Mithat Frashëri” në Gurakoc , kulmi
- Paisje kabineti , kimi, biologji, gjeografi dhe muzikë për shkollat
- Furnizimi me rekuizita sportive për nevojat e shkollave
- Instalimi i kamerave në Institucionet arsimore (shkollat dhe kopshtet)
- Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme në sh.f. “Bajram Curri” - Dubravë
- Ndërtimi i hapsirave të jashtme në shkollat e komunës së Istogut (Bajram Curri-Istog, Trepça-Banjë
- Blerja e ulësve për shkollat e mesme ,
- Blerja e paisjeve për kabinetin e informatikës,
- Ndërtimi i këndit të lojrave për parafilloret e shkollave fillore të Komunes së Istogut ,
- Ofrimi i Sigurimeve aksidentale për nxënësit të IAPP “Mithat Frashëri” - Gurakoc.

Projektet e reja kapitale të cilat kryesisht janë të financuara nga MASHTI- janë:

-Palestra sportive në Gjimnazin “Haxhi Zeka”-në Istog.

-Shtrirja e rrjetit-Digjitalizimi i Gjimnazit “Haxhi Zeka”-në Istog.

Shpenzimi i Buxhetit në Drejtorinë Komunale të Arsimit, për periudhën Korrik-Dhjetor 2023, për kategorinë mallra dhe shërbime dhe Komunal, është:

INSTITUCIONI	M+SH	KOM	KAPITALE	TOTALI
DKA	€ 60,879.12		€ -	€ 60,879.12
ARSIMI PARAFILLOR	€ 22,942.94	€ 3,067.18	€ -	€ 26,010.12
ARSIMI FILLOR	€ 29,291.83	€ 13,793.12	€ -	€ 43,084.95
ARSIMI I MESEM	€ 4,421.22	€ 3,963.02	€ -	€ 8,384.24
TOTALI	€ 117,535.11	€ 20,823.32	€ -	€ 138,358.43

Projektet kapitale të dhëna me shifra

Përshkrimi	Buxheti Aktual	Allocated	E paaloku	Aktuali	Zotim /Obligim	Buxheti i Free	% e Shpenzim
------------	----------------	-----------	-----------	---------	----------------	----------------	--------------

			ar		et në pritje	Balanc e	it
52793 INSTALIMI I KAMERAVE NË INSTITUCIONET SHKOLLORE (HAXHI ZEKA)	15,000.00	15,000.00	0.00	9,918.79	5,081.21	0.00	66.13
52798 NDERTIMI I KENDIT TE LOJRAVE PER PARAFILLOR NË 5 QERDHËT E K	20,000.00	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00	0.00	100.00
52754 PAISJE KABINETI FIZIK, KIMI, BIOLOGJI HISTORI,GJOGRAFI PËR SHKOLLA	20,000.00	20,000.00	0.00	19,777.00	223.00	0.00	98.89
52764 NDËRTIMI I NJË PJESE TE RRETHOJES MBI MURIN E SH.F.M.U TRE D	10,000.00	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00	0.00	100.00
52770 NDERTIMI I INFRASTRUKTURES SE JASHTME, GROPES SEPTIKE DHE PO	8,000.00	8,000.00	0.00	7,809.20	190.80	0.00	97.62
52785 NDËRTIMI I HAPËSIRAVE TË JASHTME NË SHKOLLAT E KOMUNËS SE IS	50,000.00	50,000.00	0.00	49,999.95	0.05	0.00	100.00
52746 BLERJA E PAISJEVE PËR KABINETIN E INFORMATIKËS	7,000.00	7,000.00	0.00	7,000.00	0.00	0.00	100.00
52748 NDËRTIMI I	70,000.00	70,000.00	0.00	70,000.00	0.00	0.00	100.00

INFRASTRUKTURËS SË JASHTME NË SHKOLLEN "							
MITHAT F							
52764 NDËRTIMI I NJË PJESE TE RRETHOJES MBI MURIN E SH.F.M.U TRE D	10,000.00	10,000.00	0.00	7,823.00	2,177.00	0.00	78.23
52789 NDËRTIMI I INFRASTRUKTURËS SE JASHTME NE SH.F. BAJRAM CURRI	20,000.00	20,000.00	0.00	19,019.00	981.00	0.00	95.10
52740 BLERJA E ULËSEVE PËR SHKOLLAT E MESME "HAXHI ZEKA DHE MITHA	10,000.00	10,000.00	0.00	10,000.00	0.00	0.00	100.00
52746 BLERJA E PAISJEVE PËR KABINETIN E INFORMATIKËS	3,000.00	3,000.00	0.00	100.00	0.00	2,900.00	3.33
53999 NDERTIMI I KULMIT TE RI NE SHKOLLEN MITHAT FRASHERI- GURAKOC	44,685.00	44,685.00	0.00	44,685.00	0.00	0.00	100.00
52748 NDËRTIMI I INFRASTRUKTURËS SË JASHTME NË SHKOLLEN "	28,842.89	28,842.89	0.00	28,842.89	0.00	0.00	100.00
MITHAT F							
TOTALI	316,527.89	316,527.89	0.00	304,974.83	8,653.06	2,900.00	96.35

Në kuadër të Drejtorisë së Arsimit nga Komisioni i formuar nga Zyra e Kryetarit që së bashku me ekspert të jashtëm është kryer faza perfundimtare dhe është aprovuar në kuvendin komunal:

- Hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të Arsimit për periudhën 2022-2026.

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT
RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2023

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporti gjatë së vitit 2023 ka realizuar disa projekte në infrastrukturë e poashtu ka zhvilluar një varg aktivitete kulturore dhe sportive. Këto aktivitete janë organizuar në nivele të shkollave, nivel lokal dhe në nivel komunal e shtetëror në të gjitha degët .

Projektet kapitale:

- Ndërtimi i Mureve pas Portave dhe ndërtimi i Zhveshtoreve faza 3, në Stadiumin e Futbollit ” Demush Mavraj “
- Digjitalizimi i Bibliotekës dhe Muzeut të Qytetit
- Ndërtimi i hapësirave për lexim në Shtëpinë e Kulturës “Adem Jashari”
- Ndërtimi i shtegut për këmbësor nga Vieëpoint në Qungella
- Ndërtimi i Via Ferrata në Mokën
- Konzervimi i Bregut të Kishës në fshatin Sudenicë
- Konzervimi dhe restaurimi i monumenteve kulturore në komunën e Istogut.
- Nndërtimi i rrethojave të poligonave sportiv në Shkollat “Bajram Curri” dhe “Mithat Frashëri”

Në Sektorin e Kulturës janë realizuar këto aktivitete :

- Për nder të Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovë është realizuar program kulturo-artistik me këngë dhe valle.
- Për nder të Ditës së Pavarësisë është hapë Ekspozita Arkeologjike në Shtëpinë e Kulturës në Istog.
- Për nder të Ditës së Pavarësisë është promovuar libri “Nga Muret e Stambollit”
- Për Ditën e pranveres u promovua libri “ Si troket Vjeshta “
- Me 13 Prill promovimi i librit “Këngë e Klithmë “
- Me 10 Maj me rastin e Ditelindjes së Ish Kryetarit z.Fadil Ferati është promovuar libri “ E kujtojmë Fadil Feratin” - ribotim.

- Për nder të Ditës së Çlirimit të Istogut me rrethinë është mbajtur program kulturo-artistik.
- Promovimi i librit “Mall për Ty”
- Për nder të 28 Nëntorit u promovua libri tradicional me titull “Zëri frymëzues i nxënësve krijues” - i 23-ti më radhë.
- Për nder të 28 Nëntorit është mbajtur program kulturo-artistik dhe ekspozita “Java Kuq e Zi” me asete të trashëgimisë tonë kulturore nga Muzeu i qytetit, ku u përfshinë fëmijët e të gjitha kopshteve, klasëve përgatitore dhe klasëve të para të të gjitha shkollave të komunës tonë.
- Gjatë gjithë vitit Komuna e Istogut dhe DKRS ka mirëpritur dhe ka përkrahur në forma të ndryshme dhe financiare OJQ-të që merren me promovimin e vlerave kulturore në Komunën tonë.

Nga Sektori i Rinisë dhe Sportit janë realizuar këto aktivitete :

1. Është organizuar Turniri Tradicional në shah kushtuar “Tre dëshmorët e shkollës shqipe” Ku në këtë turnir morën pjesë shahistët më të mirë Kosovarë, vlen të veçohet se këtë vit turniri ishte ndërkombëtarë.
2. Për nder të Ditës së Pavarësisë janë organizuar aktivitete Rinore .
3. Në bashkëpunim me OJQ “Sporti Shkollorë” janë organizuar gara në futboll, Hendboll, Basketboll, dhe Ping-pong. Në këto gara kanë marrë pjesë ekipet e përzgjedhura nga të gjitha shkollat e Komunës së Istogut.
4. Është mbajtur turniri tradicional “Labinot Alijaj – Labi”
5. Gara në futboll dhe hendboll janë mbajtur edhe në kuadër të shkollave të mesme.
6. Komuna e Istogut Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për veç këtyre aktiviteteve, ka përkrahur klubet sportive që janë të licencuara në Federatat përkatëse me mjete materiale pra në bazë të buxhetit që posedojmë kemi përkrahur klubet sportive.
7. Me angazhimin e përbashkët me udhëheqësit e klubeve janë zhvilluar shumë aktivitete dhe janë arritur rezultate të klubeve si : - Klubi i Hendbollit Istogu i cili është shpallur Kampion i Kosovës dhe Kampion i Kupës së Kosovës në Hendboll për vajza.
8. Po ashtu edhe Klubi i Basketbollit Istogu KB.ISTOGU është Fitues i Ligës së Parë dhe është inkuadruar në Superligën e Basketbollit të Kosovës.
9. Është organizuar Turniri Tradicional në Karate “Adem Jashari”.

10. Për 28 Nëntor është mbajtur aktiviteti me OJQ-të Rinore - Up To Youth dhe Creativ youth group “Të pikturojmë së bashku” dhe ecje simboleke deri në View point – ngritja e Flamurit Kuq e Zi.

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE HIDROEKONOMI RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2023

Sektori i Bujqësisë

Aktivitetet në periudhën janar- dhjetor/2023

Komuna e Istogut përmes politikave dhe strategjive zhvillimore është e orientuar në mbështetje të faktorëve të prodhimit, në stimulimin e fermerëve dhe në krijimin e një ambienti sa më të favorshëm zhvillimor. Këto politika dhe strategji janë duke krijuar mundësi që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm dhe një shfrytëzim shumë me efikas i resurseve natyrore të cilat i posedon komuna jonë.

Bujqësia dhe pylltaria janë sektorët kryesorë të cilët mund të kontribuojnë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit.

Duke u bazuar në plan programin e punës në kuadër të Drejtorisë brenda periudhës raportuese janë zhvilluar takime me grupet e interesit-fermerët, shoqatat e ndryshme, institucione të ndryshme etj. Realizimi i aktiviteteve të ndryshme në sektorin e bujqësisë që kanë qenë planifikuara në programin e punës.

1. Aktivitetet në periudhën, janar- dhjetor 2023

Në kuadër të DBPZHR-së nga muajin janar janë realizuar një mori aktivitete. Ndër me kryesorët do të paraqiten të specifikuar sipas kohës në të cilën kanë ndodhur.

- Në muajin janar janë përgatitur të gjitha kërkesat dhe lëndët e vitit paraprak, ku janë dorëzuar për arkivim tek zyrtarja kompetente e arkivës komunale;
- Po ashtu jemi përgatitur dhe kanë përfunduar me kohë procedurat për rritje të stafit në drejtori për pagesa direktë (janë pranuar 4 zyrtar të rinj me kontrata për shërbime të veçanta ,përmes ligjit të prokurorit, të cilët janë trajnuar dhe të përgatitur për procedurat e aplikimit dhe digjitalizimit të parcelave dhe kanë punuar në aplikimin e fermerëve për pagesa direkte.
- Janë bërë të gjitha përgatitjet e furnizimit me material shpenzues dhe pajisje teknologjike për mbarëvajtjen e procesit të aplikimit për pagesat direkte
- Janë iniciuar procedurat e prokurimit për projektet kapitale dhe zotimi i mjeteve
- Pranimi dhe përgjigjeje në kërkesa të palëve
- Shërbime të tjera në kuadër të drejtorisë si; vërtetime për fermer, vlerësimi i dëmeve të ndryshme , etj.
- Funksionalizimi i zyrës për shërbime këshillimore për fermer dhe ofrimi i këshillave dhe trajnimeve të ndryshme për fermer
- Ofrimi i trajnimeve për fermer në bashkëpunim me MBPZHR dhe donator të tjerë
- Përgatitja dhe shpallja e thirrjes për organizimin e aktivitetit tradicional “Te qethat 2023” , aktivitet i cili promovon vlerat tradicionale të komunitetit të blegtorëve
- Përgatitja dhe shpallja e thirrjes për organizimin e aktivitetit “Dita e Mollës 2023”
- Përgatitja dhe shpallja e thirrjes për mbështetje me sera ,sipas memorandumit të bashkëpunimit të nënshkruar në mes të komunës dhe organizatës Islamik Relief Kosova

- Organizimi i aktivitetit dita e mollës 2023
- Përzgjedhja e 51 fermerëve përfitues ne sera me sipërfaqe prej 100 m² për kultivimin e perimeve
- Vlerësimi i dëmeve nga vërshimet dhe fatkeqësitë e tjera natyrore, ne kuadër te komisioneve ad-hok dhe komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve
- Janë përfunduar procedurat dhe ankandi për dhënien ne menaxhim te vend gjuetisë “ Mokna “ , ka mbet te realizohet vetëm nënshkrimi i kontratës, ne pritje te pëlqimit te MBPZHR , me përfituesin e ankandit

2. Lëndët e pranuar dhe zgjidhja e tyre

2.1 Kërkesat drejtuar Drejtorisë se Bujqësisë Pylltarisë dhe Hidroekonomis

PËRMBAJTJA

- Gjatë kësaj periudhe raportuese janë shqyrtuar dhe vendosur ne total për **2589.00** kërkesa te ndryshme të palëve, drejtuar në drejtorin e bujqësisë.

Pranuar	Nr. i lendeve	Ne proces	Miratuara	Refuzuara	Pezulluar	Anuluar
Kërkesa te rregullta	415.00	45	177.00	186	4	3
Aplikime për pagesa direkte	2010.00		2010.00			
Kërkesa për vlerësim te dëmeve nga fatkeqësitë natyrore	164.00		164.00			
Totali i lendeve te trajtuara	2589.00					

Aplikimi për pagesat direkte, sipas sektorëve

Nr.	Sektori		Viti 2023	Sipërfaqja/ha	Nr. I aplikacioneve
1	Lavërtari	Grurë sipërfaqe		2,372.62	610
		Grurë kg		3312020	152
		Grurë për farë		150.44	2
		Misër		1,937.33	589
		Thekër		6.96	5
		Elb		29.82	21
		Tërshërë		157.22	22
		Lule dielli		/	/

2	Perime kulturë	Perime në fushë		117.4	71
		Perime në sera		2.74	10
		Fasule monokulturë		1.59	2
		Kunguj misiri		1.77	6
		Vreshta		10.68	2
3	Pemëtari	Pemë		349.8	190
		Pemë të imta		6.39	87
		Material fidanor		43,500	1
4	Blegtori	Lopë qumështore		4,499 krerë	420
		Qumësht litra	Gjashtëmujori I	2768140.14	80
			Gjashtëmujori II	2150470.20	82
		Bletë		6,132 koshere	110
		Dele		8,070 krerë	79
		Dhi		802 krerë	12
		Viça për majmëri	Gjashtëmujori I	316	21
			Gjashtëmujori II	107	8
		Dosa		7	2
5	Therje të raportuara	Gjedhe	Gjashtëmujori I	/	
			Gjashtëmujori II	170	1
6	Shpezëtari	Pula		21,500	2
7	Akuakulturë	Peshk	Gjashtëmujori I	276422.18	3
			Gjashtëmujori II	397266.7	3
8	Bimë mjekësore dhe aromatike	Konvencionale		54.94	12
9	Bujqësi organike	Organike		65.89	5
Totali:		Ara		5,265.59 (Ha)	
		Qumësht (litra) I+II		4,918,610.34 (Litra)	

	Akuakulturë (Peshk) I+II	673,688.25 (Kg)
	Viça për majmëri I+II	423 (Copë)

Totali i aplikimeve për pagesa direkte ne te gjithë sektorët gjatë gjithë vitit ka qenë 2010. 00 kërkesa.

3. Projektet kapitale

Ne këtë vit janë implementuar projekte qe kanë të bëjnë me përmasimin e infrastrukturës së ujitjes ,hapja e një rruge malor dhe mirëmbajtje të rrugëve malore për tu mundësuar qasje me të lehtë blegtorëve në kullosa.

Janë kryer procedurat në implementim të projekteve kapitale sipas buxhetit të aprovuar të komunës

- Mirëmbajtja e rrugëve malore Lot 1 dhe Lot 2
- Betonimi i kanaleve të ujitjes
 - Betonimi i kanalit të Prekallës
 - Ndërtimi i kanalit të ujitjes lagjja Bujupet
 - Ndërtimi i kanalit të ujitjes Tomoc,kanali i Vogel
 - Ndërtimi i kanalit të ujitjes, Lagjeja Demaj-Vrellë
 - Ndërtimi i kanalit të ujitjes Januzaj_Gashet Prigod
 - Ndërtimi i kanali i madh-Istog i Poshtëm
 - Ndërtimi i kanali i madh-Istog i Poshtëm- Vazhdim
 - Ndërtimi i kanalit Tregu i Qytetit
 - Ndërtimi i Likeneve artificiale në bjeshke
 - Ndërtimi i kanalit të Baicës
 - Ndërtimi i kanalit të Dobrushës në Baicë
- Ndërtimi i rrugës malore Zhakovë- Javor,
- Ndërtimi i rrugës malore Kaliqan –shkalla e Kaliqanit
- Ndërtimi i rrugës malore Shoshan-Lugu i Mëhallës dhe lugu i butë-Lugu i Mehajve

4. Sektori i pylltarisë

1. Aktivitete për periudhën janar- dhjetor / 2023

- Është vazhduar me aktivitet të rregullta sipas planifikimeve vjetore, angazhim në mbrojtje dhe ruajtje të pyjeve, florës dhe faunës
- Me vendim të Kryetarit të komunës në muajin korrik janë bërë regjistrimet e përgjithshme të demit pyjor
- Është bërë shijimi i masës drunore së bashku me zyrën rajonale të APK-së , për shitje të rregullt dhe për furnizim me qytetar
- Është bërë lëshimi i lejeve për prerje në pyje private, damkimi dhe dhëna e flet përcjelljeve
- Rekrutimi i stafit roje pylli në laura dhe aktivitete të tjera nga fusha e

Përmbledhje tabelore e aktiviteteve për përdhën raportuese

Shitje e masës drunore në	Shitje e lirë	Fletëparaqitjet	Konfiskimet	Shitjet
---------------------------	---------------	-----------------	-------------	---------

bazë te kontratave			për qytetar					totale €
Dru zjarri m³	Ahu teknik m³	Breu m³	Dru zjarri/ m³	Penale	Kundë rvajtje	Dru teknik m³	Dru zjarri m³	
2162.00	16.00	00	1460.48	51	13	20.52	65.15	3622.64

5. Sfidat

Drejtoria e bujqësisë këtë vit raportues është përballur me sfida të shumta në përmbushjen e detyrave dhe funksionimit si me poshtë:

- Vonesa nga kompania projektuese , e kontraktuar nga komuna për përgatitjen e projekteve ekzekutuese të investimeve kapitale
- Mungesë të trajnimeve të stafit për menaxhimin e kontratave të projekteve, vlerësimit të tenderëve dhe trajnime profesionale
- Sipërfaqet e tokave bujqësore komunale të cilat nuk janë dhënë në shfrytëzim përmes ankandit
- Numri i madh i kërkesave të fermerëve për ndihmë financiare për dëmtim të kafshëve shtëpiake nga kafshët e egra dhe ngordhjet natyrore, dëmtim të objekteve bujqësore etj.
- Mungesa e planit për menaxhimin e tokave bujqësore
- Mungesa e Planit shumëvjeçar për bujqësi dhe zhvillim rural
- Numri i vogël i trajnimeve për fermer të organizuara nga shërbimi këshillimor i MBPZHR

6. Rekomandime

- Vazhdimi i procedurave për dhënie në shfrytëzim të tokave bujqësore për periudhë afat shkurtër (1-15 vite) .
- Rekrutim i stafit të rregullt profesional në kuadër të drejtorisë
- Organizimi i trajnimeve për stafin në menaxhim të kontratave, vlerësim të tenderëve , vlerësim të punimeve të kryera dhe trajnime të tjera profesionale
- Hartimi i planeve strategjike për bujqësi dhe zhvillim rural dhe planit për mbrojtjen e tokës bujqësore.

7. Përfundim

Me gjithë sfidat e lartë cekura, në kuadër të stafit të drejtorisë ka pasur angazhime në përmbushje të detyrave dhe implementim të projekteve. Po ashtu gjatë kësaj periudhe raportuese kemi mbajtur kontakte të rregullta me institucionet e nivelit qendror, shoqata të ndryshme dhe komunikime të tjera , me qëllim të ndikimit që përmes këtyre aktiviteteve të përmirësohen dhe ndihmohen fermerët në zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë.

Implementimi i rekomandimeve të lartcekura do të mundësoi sektorit të bujqësisë një funksionalizim dhe përmbushje të detyrave dhe të kompetencave , sipas ligjeve në fuqi. Mungesa e stafit të rregullt

po pamundëson edhe themelimin e disa komisioneve profesionale shumëvjeçare që na obligojnë aktet ligjore në fuqi.

DREJTORIA E SHËNDETËSISË

RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2023

Gjatë vitit 2023 e tërë puna dhe angazhimi i Drejtoratit për Shëndetësi ka qenë e drejtuar në përmirësimin dhe në ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore për qytetarët e komunës së Istogut. Rëndësi e veçantë i është kushtuar sidomos zbatimit të reformave në lëmin e Mjekësisë Familjare, përmirësimit të kushteve të punës dhe të infrastrukturës në objektet shëndetësore. Gjatë kësaj periudhe të raportimit, në bashkëpunim me menaxhmentin e QKMF kemi bërë vizita të vazhdueshme në QKMF dhe të gjitha qendrat tjera shëndetësore (QMF dhe AMF), ku jemi njoftuar për së afërmi me kushtet dhe nevojat e tyre. Pastaj vëmendje i kemi kushtuar edhe shërbimit të diagnostikës (Rëntgenit dhe shërbimit të Laboratorit). Për funksionimin sa më të mirë dhe pa ndërprerë të këtij shërbimi, kemi bërë zgjerimin e listës së analizave të cilat mund të kryhen në këtë shërbim. Kemi bërë furnizimin e rregullt me reagenca dhe për këtë qëllim në këtë vit janë shpenzuar rreth **19,000.00€**. Në shërbimin e radiologjisë jemi pajisur me pajisje të nevojshme (detektor), për të qenë në funksion mamografin, vlera e të cilave ka qenë **19,850.00€** dhe tani kemi futur në funksion aparatën e Mamografisë përmes të cilit bëhet ekzaminimi dhe zbulimi i hershëm i kancerit të gjirit, po ashtu në këtë shërbim kemi angazhuar Radiologun si konsulent, i cili bënë leximin dhe punimin e raporteve për të gjithë ata të cilët i nënshtrohen ekzaminimit me Mamograf. Interesimi i grave për ta bërë ekzaminimin përmes mamografisë është shumë i madh dhe deri me tani janë realizuar rreth 109 ekzaminime.

Sa i përket projekteve të cilat kanë qenë të parapara për vitin 2023, kemi blerë një **Automjet-Kombi për nevoja të shërbimit të Dializës** dhe për shërbime të tjera për nevoja të qytetarëve, vlera e këtij automjeti ka qenë rreth **43,800.00€**.

Në dy qendra të mjekësisë familjare në QMF Banjë dhe QMF Rakosh, kemi vënë në funksion sistemin e ngrohjes përmes Pompave Termike, ky projekt ka kushtuar rreth **12,558.00€**;

Sa i përket Infrastrukturës gjatë vitit 2023, në kuadër të mirëmbajtjes së Objekteve Shëndetësore kemi bërë disa renovime të brendshme në objektin e QKMF, QMF dhe Ambulancave Shëndetësore. Vlera e këtyre renovimeve ka qenë rreth **15,000.00€**.

Rëndësi të veçantë gjatë kësaj periudhe i kemi kushtuar rregullimit të Infrastrukturës dhe ambientit për rreth Objekteve shëndetësore. Në kuadër të këtij projekti kemi bërë ndërtimin e **Rrethojës dhe Rregullimit të Oborrit në Ambulancën e Mjekësisë Familjare në Zallq në vlerë prej 29,893.00€**;

Rregullimi i Oborrit në Ambulancën e Mjekësisë Familjare në Uçë në vlerë prej 6,785.00€;

Rregullimi i Oborrit në Ambulancën e Mjekësisë Familjare në Veriq dhe Ambulancën në fshatin Cerkoz në vlerë prej 20,870.00€

Shqyrtimi i kërkesave- Gjatë kësaj periudhe, këtij drejtorati i janë parashtruar një numër i madh i kërkesave të cilat kanë të bëjnë me kërkesa për ndihmë financiare për shërim dhe blerje të medikamenteve, për këtë qëllim janë ndarë **15,000.00€** dhe kanë përfituar mbi 90 individ. Kemi pasur edhe një numër të madh të kërkesave për kompensimin e shpenzimeve të karburanteve për personat të

cilët janë në Hemo-dializë, të cilët janë në gjendje të rëndë shëndetësore dhe si mjet transporti përdorin automjetet private, pastaj për personat të cilët trajtohen me kemio-terapi dhe rrezatim në institutin Onkologjik pranë SHSKUK. Për grupin e parë kemi ndarë nga 57 lit. karburant në muaj ndërsa për grupin e dytë nga 10 lit. karburant për një relacion Istog-Prishtinë dhe anasjelltas. Për këto dy qëllime gjatë vitit 2023 janë dhënë rreth **21638 litra** Karburant në shumë prej rreth **26,920.15€**

Edhe në këtë vit kemi vazhduar me projektin me bashkëfinancim të Komunës së Istogut dhe Caritas Kosova me titull “ **Përkujdesja Shëndetësore Shtëpiake dhe Ambulator –Home Care 2023**” i cili realizohet me vizita sistematike në shtëpi për personat dhe familjet me nevojë. Implementues i këtij projekti është Caritas Kosova dhe zgjatë nga 01.01.2023 deri me 31.12.2023. Vlera e këtij projekti është **150,000.00€**. Caritas Kosova do të participoj në këtë projekt me pajisje, Infrastrukturë menaxhuese, pajisje shëndetësore në vlerë prej **20,000.00 €**, ndërsa Komuna e Istogut për këtë qëllim ka ndarë shumë prej **130,000.00€**. Përmes këtij projekti kemi realizuar punësimin e 25 punëtorëve kryesisht staf shëndetësorë. Përmes këtij projekti gjatë këtij viti janë realizuar **1685** vizita shtëpiake dhe **5922** shërbime duke ju ofruar shërbime të ndryshme mjekësore për njerëzit me nevojë.

Home-Care Istog ka pasur mbështetje të vazhdueshme nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, janë siguruar vizitat në teren nga mjekët, për përfituesit e projektit, është bërë sigurimi i medikamenteve esenciale nga barnatorja qendrore e Qkmf- së Istog, sigurimi i gazave, instrumenteve sterile, sigurimi i kateterave , qeseve për stomë etj.

QKMF

Gjatë vitit 2023 në QKMF janë kryer këto shërbime: në Shërbimin e Mjekësisë Familjare në QKMF, QMF dhe AMF janë kryer **26925** vizita mjekësore, dhe rreth **65053** shërbime.

Numri i shërbimeve Infermierore duke përfshirë dhënien e terapisë paranterale, lidhje dhe pastrim të plagëve etj. Gjithsejtë janë kryer **223020** shërbime.

Shërbimi i Laboratorit janë trajtuar **5283** pacientë me rreth **248549** shërbime Laboratorike.

Shërbimi i Rentgenit janë trajtuar **997** pacientë me rreth **6071** shërbime.

Shërbimi Stomatologjik janë trajtuar **3625** pacientë me rreth **6180** shërbime

Pediatri – janë trajtuar **3460** pacientë me rreth **6241** shërbime.

Shërbimi i Emergjencës janë trajtuar **29279** pacientë me rreth **51919** shërbime.

Shërbimi Internistik janë trajtuar **6745** pacientë me rreth **11785** shërbime.

Numri i vizitave shtëpiake: Nga ekipi mjekësorë i përbërë nga Mjek dhe Infermier, janë kryer **576** vizita;

Shëndeti i Nënës dhe Fëmijës 0-3 vjet: Vizita për shëndetin e nënës dhe fëmijës kanë qenë gjithsej **1032**.

Gjinekologji - maternitet: Vizita gjinekologjike **416**, me rreth **2210** shërbime të maternitetit

Shëndeti i Nënës dhe Fëmijës: Vizita për shëndetin e nënës dhe fëmijës kanë qenë gjithsej **132**

Vizita mjekësore nga Shëndeti Mendor: janë trajtuar **434** klient .

Vaksinimi

Janë aplikuar **9742** vaksina dhe rreth **17753** shërbime

Vaksinimi anti - covid: 16 vaksina

SAT - Serume të lëndimeve (Antitetanik) 140 serume

SAV – Serume të kafshimit të gjarpërit (Antiviperik), 2 serum

Transporti i pacienteve në Hemodializë - Pejë:

Janë transportuar 12 pacient të rregullt sipas orarit, 2 ndërrime 3 herë në javë.

Të hyrat vetanake:

Gjatë vitit 2023 nga Bashkëpagesat (participimi) janë realizuar të hyra gjithsej **55,604.70 €**.

Furnizimi me Barna:

Furnizimi me barna dhe material shpenzues nga Lista Esenciale ka qenë relativisht i mirë.

Mungesat e furnizimit nga Lista Esenciale janë përmbushur nga Drejtoria për Shëndetësi dhe për këtë qëllim janë shpenzuar rreth **65,000.00€**

Furnizimi me insulina ka qenë i rregullt.

Aktivitetet

Vazhdimi me planprogramin e ZHVP-së për Mjek dhe Infermier:

anë zhvilluar ligjërata për ZHVP sipas plan-programit. Nga muaji janar, kemi filluar me plan-program për Infermier, ku janë zhvilluar në total 9 ligjërata për Infermier. Po ashtu, janë mbajtur trajnime të organizuara nga AQH (Organizata për Cilësi në Shëndetësi), trajnime mujore për punëtorët e QKMF-së Istog, si dhe trajnime për stafin menaxherial në regjionin e Pejës. Trajnimi i trajnerëve nga Shoqata Medika Gjakova në Shqipëri (mjekë dhe infermierë) ka përfshirë aktivitete të rëndësishme për zhvillimin e kapaciteteve profesionale.

Gjithashtu, është caktuar një grup punues për planifikimin komunal në fushën e shëndetësisë me strategji për periudhën 2024-2028. Janë zhvilluar takime me OJQ Lirija, me qëllim të informimit të qytetarëve në lidhje me sëmundjen e tuberkulozit.

Për të përmirësuar kapacitetet laboratorike, është realizuar furnizim me pajisje për matjen e sheqerit tremujorësh për laborator nga AQH. Po ashtu, ka pasuar furnizim nga MSH (Ministria e Shëndetësisë) me materiale për menaxhimin e mbeturinave, duke kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës dhe proceseve mjedisore në komunën tonë.

***DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM
RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2023***

Spektori për Mbrojtje dhe Shpëtim

- ❖ Plani i Gatishmërisë Emergjente i cili është bazë për hartimin e Planit Operativ Emergjent është plotësuar me shënime të reja siç janë shënimet nga institucionet e Arsimit dhe Shëndetësisë, pas vërshimeve të nëntorit 2022 dhe janarit 2023 e mbas takimeve të shumta me UNDP-AME i njëjti së bashku me planin e vlerësimit të rrezikut është dorëzuar UNDP-së për vlerësim dhe plotësim eventual.

- ❖ Në bashkëpunim me AME, UNDP dhe Ministrin e Planifikimit hapësinor janë mbledhur shënimet e duhura për hartimin e hartave zonale të rrezikshmërisë nga vërshimet
- ❖ Plani Operativ Emergjent është miratuar nga Asambleja Komunale është publikuar në veb faqen e Komunës.
- ❖ Plani në rast tërmeti është bërë grumbullimi i shënimeve të bodrumeve të ndërtesave kolektive të cilat në situata emergjente mund ti plotësojnë kushtet për strehimore kolektive, por lëvizjet e shpeshta të banorëve në disa ndërtesa shumë kështu paraqesin problem për hartimin e planit për strehim dhe evakuim në rast rreziku. Poashtu mos mbulimi i vendit të lirë të zyrtarit për planifikim në kuadër të sektorit për Mbrojtje dhe shpëtim shkakton ngecje reale në hartimin e Planit.

Po ashtu lidhur me hartimin e këtij plani problem në vazhdim paraqet mungesa e akteve ligjore normative dhe mungesa e hapësirave për strehim, gjegjësisht strehimoreve. Për këtë arsye jemi në fazën e identifikimeve të bodrumeve në objekte kolektive duke identifikuar edhe pronaret me qëllim vlerësimi për shfrytëzim si strehimore në raste emergjente

- ❖ Do të ishte mirë që Drejtorati i Administratës së bashku me Drejtorin e Financave të nënshkruajnë marrëveshjet e mirëkuptimit në pritje, me klauzulë se kompensimi për angazhim do të bëhet proporcionalisht me çmimin e tregut në ditën e angazhimit në intervenim.
- ❖ Sektori është përgjigjur kërkesave të qytetarëve me shkrim siç janë: ndihma për dëmet e krijuara nga vërshimet e janarit, vërtetimi për plotësimin e kushteve për mbrojtje nga zjarri, vërtetime në raste të djegies së shtëpisë apo pronë personale, lëshimi i certifikatave mbi shërbimin ushtarak, vërtetime për personin e zhdukur apo të vrarë nga lufta etj.
- ❖ Drejtori i Drejtoratit dhe Udhëheqësi i Sektorit për Mbrojtje dhe Shpëtim kanë pas një varg takimesh me IOM, UNDP, FAO dhe AME si dhe organizata tjera të bamirësisë në bashkëpunim me Drejtorin e Mirëqenies Sociale për sigurimin e ndihmave materiale për familjet e prekura nga vërshimet e janarit. Drejtorati e ka paraqitur në Kuvend raportin e vërshimeve, i njëjti është miratuar dhe dorëzuar Komisionit Qendror për vlerësimin e dëmeve pranë MPB-së gjegjësisht Qeverisë së Kosovës. Me kërkesën e këtij komisioni forma e formularëve të dëmeve janë ndryshuar tri here pa ndërhyrje në vlerën e dëmeve individuale si dhe vlerën totale të dëmeve. Qeveria e Kosovës ka marrë Vendim për kompensimin e dëmeve në Bujqësi dhe ekonomi familjare në vlerë 90% të dëmit mirëpo ka pasur probleme me pagesa shkaku i gjirollogarive dhe sistemit në ministrin e financave, për këtë arsye kemi ankesa të shumta nga një numër i të dëmtuarve që ende nuk ju kanë dalë në gjirollogari mjetet financiare.
- ❖ Drejtorati në bashkëpunim me komisionin lokal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera ka bërë vlerësimin e dëmeve nga vërshimet e janarit. Vlera e përgjithshme e dëmeve ka qenë 2,585,511.94€. Për kompensim nga Qeveria e Kosovës janë pranuar 102,730.00€ dëme në ekonomi familjare, 142,851.94€ në bujqësi dhe 58,800.00€ në biznese.
- ❖ Në bashkëpunim me zyrtarin për monitorim të kamerave kemi hartuar projektin për kamera për Gurakoc dhe Banjë dhe përmes Kryetarit z. Ilir Ferati e kemi dorëzuar përfaqësuesve të UN nga të cilët kemi premtime se do ta mbështesin këtë projekt.
- ❖ Gjatë vitit janë kryer projekte si: renovimi i objektit të zjarrfikësve, Riparimi i automjeteve të zjarrfikësve, Trajtimi i qenve endacak, Pastrimi i projeve (pika të grumbulluara me mbeturina dhe materiale inerte) në bashkëpunim me KFOR-in Italian, Mirëmbajtja dhe zgjerimi i kamerave të sigurisë në qytetin e Istogut.
- ❖ Zyrtar të Drejtoratit poashtu janë angazhuar në komisione të ndryshme me Vendime të Kryetarit të Komunës.
- ❖ Shefi i Sektorit për mbrojtje dhe shpëtim përpos detyrave në kuadër të sektorit është i angazhuar edhe në kuadër të Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi (EVSb-së) në realizimin e projekteve në bashkëpunim me UNDP-në, me qendrën për informim dhe siguri si dhe në organizimin e mbledhjeve

të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, komisioni për të zhdukur, Shërbimin Sprovues të Kosovës për monitorimin e të dënuarve me punë në dobi të përgjithshme.

Problem të madh paraqet mos funksionalizimi i Qendrës Operative Emergjente Lokale dhe komunikimi në raste të fatkeqësive (situata emergjente), sistemi i radiolidhjeve nuk funksionon fare. Në si sektor bazuar edhe në përshkrimin e detyrave të punëve kemi qenë të angazhuar në kryerjen e detyrave bazuar në kërkesat e qytetarëve, si dhe kemi kontribuar në hartimin e projekteve të ndryshme nga lista e projekteve të parapara për këtë vit.

KATEGORIZIMI I ZJARREVE DHE INTERVENIMEVE SIPAS MUAJVE GJATË VITIT 2019

LLOJI I INTERVENIMIT	Jan.	Shku.	Mar.	Prill	Maj	Qersh	Korr	Gush	Shta	Tet.	Në nt.	Dh je.	GJTHESEJ
----------------------	------	-------	------	-------	-----	-------	------	------	------	------	-----------	-----------	----------

Realizimi i numrit të përgjithshëm të intervenimeve, struktura e zjarreve dhe int.tjera Jan-Qersh 2023

	Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. i Teknike	Nr.i shërbimeve	Aksidente rrugore	Vërshime	Të rejsh	Të lënduar			Të vdekur		
								zj.	qyt.	tot	zj.	qyt.	tot
023													
ar	24	5	2	0	1	16	0	0	0	0	0	0	0
urt	21	17	3	0	1	0	0	0	5	5	0	0	0
s	20	12	5	1	1	1	0	0	0	0	0	0	0
	13	10	2	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0
	4	4	0	0	0	0	0	0	2	2	0	0	0
shor	7	1	3	1	1	1	0	0	0	0	0	0	0
rik	28	19	4	3	1	1	0	0	9	9	0	1	1
sht	51	42	2	4	2	1	0	0	2	2	0	0	0
ator	78	59	4	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0
or	38	22	1	11	4	0	0	0	3	3	0	0	0
itor	14	7	5	0	2	0	0	1	4	5	0	1	1
etor	12	8	2	0	2	0	0	0	3	3	0	0	0
hsejtë	310	206	33	35	16	20	0	1	27	28	0	2	2

1	ZJARRË	5	17	12	10	4	1	19	42	59	22	7	8	206
2	INTERVENIME TEKNIKE	2	3	5	2	0	3	4	2	4	1	5	2	33
3	SHËRBIME	0	0	1	0	0	1	3	4	15	11	0	0	35
4	AKSIDENTE KOMUNIKACIONI	1	1	1	1	0	1	1	2	0	4	2	2	16
5	VËRSHIME	16	0	1	0	0	1	1	1	0	0	0	0	20
6	ALARME TË RREJSHME	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Gjithësejtë:	24	21	20	13	4	7	28	51	78	38	14	12	310
1.	Ndarja analitike e zjarreve në :	OBJEKTE NDËRTIMORE												
1.1	Banesa – shtëpi	0	1	2	0	0	0	1	1	0	0	0	2	7
1.2	Objekte ndimëse	2	0	0	0	2	0	0	0	0	1	1	0	6

1.3	Plevica - shtalla	0	1	0	0	0	0	2	3	0	0	1	1	8
1.4	Objekte kolektive (banesa)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
1.5	Oxhaqe	0	4	2	0	0	0	0	0	0	0	0	1	7
1.6	Të tjera	0	0	1	1	1	0	1	0	0	0	0	0	4
	Gjithësejtë:	2	6	5	1	3	0	4	4	0	1	2	4	32
2.	Ndarja analitike e zjarreve në:	OBJEKTE EKONOMIKE												
2.1	Publike	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
2.2	Objekte Biznesi	0	0	1	0	0	0	1	0	0	0	0	0	2
2.3	Objekte Indusiale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2.4	Të tjera	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	1
	Gjithësejtë:	1	0	1	0	0	0	1	0	0	1	0	0	4
3.1	Paisjet elektrike / trafo	0	1	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	2
3.2	Paisjet shpërndarëse	0	0	1	0	0	0	3	3	0	0	2	0	9
3.3	Gjenerator	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3.4	Të tjera	0	4	0	0	1	0	0	0	0	0	0	1	6
	Gjithësejtë:	0	5	1	0	1	0	3	3	1	0	2	1	17
4.	Ndarja analitike e zjarreve në:	SIPËRFAQE TË HAPURA												
4.1	Mal	0	3	0	0	0	0	1	7	7	2	0	0	20
4.2	Sipërfaqja e djegur (hektar)	0	13,5	0	0	0	0	1,00	9,00	22,50	5,00	0	0	51,00
4.3	Bari i thatë	0	1	2	1	0	0	4	19	42	14	0	0	73
4.4	Sipërfaqja e djegur (hektar)	0	1,0	2,5	1,0	0	0	3,5	20,5	53,50	14,00	0	0	96,00

Sektori i parandalimit :

Nga intervenimet e cekura më lart, për 15 raste janë punuar raportet përkatëse

Të gjitha këto raste janë shoqëruar më dëme materiale dhe fatmirësisht pa viktime në njerëz, pesë raste janë shtëpi më dëme të konsiderueshme, 2 vetura, 1 objekt kulti, ushqim për bagëti, objekte përcjellëse etj.

Në bashkëpunim me Drejtoratin e Bujqësisë kemi bërë monitorimin e korrje-shirjeve në territorin e Komunës.

Duhet cekur se një numër i zjarreve është shkaktuar edhe nga rrjeti furnizues elektrik i cili në disa fshatra është në gjendje shumë të keqe dhe paraqet rrezik për sigurinë e qytetarëve, duhet cekur rrjetin elektrik Tuçep-Osojan, ana juglindore. Ky rrjet ka vite që nuk është sanuar gjendja.

Janë nxjerrë komunikata sensibilizimi për qytetarë për të shtuar kujdesin në sezonin veror, me këshilla për mënyrën e sjelljes së tyre gjatë këtij sezoni. Komunikatat janë transmetuar përmes mjeteve të informimit lokale si dhe rrjeteve sociale

Forma tabelare e rasteve te zjarreve për te cilat janë punuar raportet përkatëse dhe është bërë vendshikimi i rastit, 2023

Nr. dhe data	Pronari	Shtepi / biznes	Obj. percjell ëse	Te tjera (ushqim bagëti e dru prod.bujq. vetura), etj.	Shkak i zjarrit.	Dëmet	Shenime
Date :05.01. 2023 Nr: 001 / '23	Bajram Rexhep Ahmet aj në fshatin Pemishtë, rruga; „Demir Ahmeti”	Shtepi		/	zjarri mund te jet i problemeve me instalim elektrik.	instalim elektrik, paisje amvisnij e dera hyrëse, fasadë në hyrje	rrjeti furnizues në gjendje tejet te keqe
Date :06.01. 2023 Nr: 002 / '23	Qazim (Vesel) Metaj Banjë, , rruga; „Mujë Dreshaj ” nr 36.	/		veturë	rasti është Zjarrvënije	vetura terësisht	rast I perseritur
Date :13.01. 2023 Nr: 003 / '23	Skender (Brahim) Hasani, Banana S.H. në rrugen „Deshmorët Dervishaj ”			kontajner mbeturinash	mbetjet e hirit		Moskujde si njerëzorë.
Date : dt: 26.01.2023 , Nr: 004 / '23	Kazerma e FSK-S , Ushtaret e NATO-s		objekt	/	Instalim i vjeter, ngarkesa me nxemëse	I tërë objekti	
Date : 01.02. 2023 Nr:005 / '23	Xhemajl (Arif) Rexhaj Cercë, rruga „Asllan Beka” nr; 79	Shtepi		/	Oxhaku	ekzekuti m jo professi onal I oxhakut	gjat ndertimit është punuar keq oxhaku, në kontakt me masen drunore
Date :	Lavdim (Muzli)		ahur	/	zjarrvënije	I tërë	objekti

23.02. 2023 Nr: 006/ '23	Imeraj në rrugen „ Selim Bajramaj”		bagëtiye (rritjen e dhive)			objekti	është në pronë shoqërore
Date : 15.02. 2023 Nr: 007/ '23	Kujtim (Sadri) Zogaj rruga „Diaspora’ nr; 61.	Shtëpi banimi,	/	/	vet pronari, në gjendje te dehur	I tërë objektid eri në mure	pronari në gjendje të dehur ka shkaktuar zjarrë
Date : 21.03. 2023 Nr: 008/ '23	Raport i gjendjes së rrjetit elektrik në lagjen Ibrahimaj, Halilaj dhe tërë fshatin Shushicë				gjendje shumë e keqe teknike e rrjetit furnizues elektrik		kjo gjendje e rrjetit elektrik paraqet rrezik për permanent
Date : 29.03. 2023 Nr: 009/ '23	në Institutin e Mjeksisë Ligjore, në Prishtinë.				instalimi elektrik		isha pjesë e ekipit te hetimeve
Date : 29.03. 2023 Nr: 010/ '23	Afrim Kadri Idrizaj „Arben Januzaj”, nr 35	shtëpi			dyskohet në luhatjet në tension në rrjetin furnizues	pjesa instalimi t të cekur më lartë, izolimi i shtëpisë, dera e shtëpisë, streha	instalimi, pjesa furnizuese nga shtylla deri te njehsori
Date : 29.03. 2023 Nr: 011/ '23	Fidan (Xhemë) Blakaj rruga Sylë Blakaj nr 152.	shtëpi			dushohet në luhatjet e tensionit në rrjetin furnizues	paisje elektrike amvisnij e tv aparatur, reserver, etj	rrjeti furnizues ne gjendje shum te keqe teknike
Date : 19.04. 2023 Nr: 012/ '23	Tyrbja e Hoxhë Hajdarit në Veriq rruga „Podgur i”.		Objekt besimi		dyskohet zjarrvënije	dera kryesore dhe tavani i objektit,	

Date : 24.04. 2023 Nr: 013/ '23	Muhamet Loshaj në bjeshkën e Vojdullit.		Stan në bjeshkë		dyshohet zjarrvënije	I tërë stani me orendit dhe instalim et	rastet në stane po perseriten vit pas viti
Date : 21.05. 2023 Nr: 014/ '23	Selman Zeqiraj rruga Gurina nr:80			ushqim bagëtije	duket te jet zjarrvënije	600 duaj kashtë, 400 duaj sanë	dyshohet se zjarrin e ka shkaktuar kusheriri
Date :05.06. 2023 Nr; 015/23	Milaim Maraj rruga e Mullinj ëve Vrellë			veturë	probleme me instalim , vetndezje e vetures	terësisht është djegur vetura	Raportin e rastit e ka punuar kolega nga Peja, pasi ishim ne vikend ne Shqipëri.

DREJTORIA PER PUNE DHE MIREQENIE SOCIALE **RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2023**

-Punimi i kalesave për personat me aftësi të kufizuara: Në qendër të komunës së Istogut, janë ndërtuar kalesa për personat me aftësi të kufizuara me një vlerë prej 10.000€.

-Shpërndarja e pakojeve ushqimore: Janë shpërndarë mbi 400 pako ushqimore për familjet në nevojë dhe ato me gjendje të rëndë ekonomike.

-Pagesa e qerasë për familjet në nevojë: Gjatë vitit 2023, kemi realizuar mbi 15 pagesa të qerasë për familjet në kushte të vështira ekonomike.

-Blerja e gjeneratorit për Shtëpinë për Komunitet në Gurrakoc në vlerë prej 10.000€.

-Hartimi i Planit të Punës të Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve 2024-2026: Plani i punës trevjeçar (2024-2026) do të shërbejë si dokument pune për ekipin komunal për të drejtat e fëmijës, duke siguruar një mirëqenie sa më të mirë për fëmijët e komunës sonë përmes aktiviteteve që planifikojmë gjatë këtyre viteve.

-Hartimi i Statusit të Qendrës për Punë Sociale: Ky Statut përcakton dhe rregullon disa aspekte të Qendrës për Punë Sociale, duke përfshirë nocionin, emërtimin, selinë, simbolet, statusin juridik, prezantimin dhe përfaqësimin, funksionimin e veprimtarisë, si dhe përgjegjësitë e Qendrës për Punë Sociale.

-Shpërndarja e lëndës djegëse - dru zjarri për familjet me kushte të rënda ekonomike: Projekti ka pasur një vlerë prej 5000€ dhe ka përfshirë shpërndarjen e dru zjarri për familjet në nevojë. Çdo familje ka përfituar 3 metra kubë lëndë djegëse - dru zjarri, dhe këtë vit ka dyfishuar numrin e familjeve përfituese në krahasim me vitin e kaluar.

-Subvencionimi i pagesave të qeras për rastet e dhunës në familje: Bazuar në planin trevjeçar të banimit social, femrat që kanë pësuar dhunë në familje janë përkrahur me pagesën e qerasë për një periudhë 1-vjeçare. Përveç kësaj, ato janë përkrahur edhe me pako ushqimore, duke shfaqur përkujdesje dhe ndihmë në kohë të vështirë.

-Subvencionimi i Shtëpisë së Sigurtë , në vlerë prej 3000 € -Viktimat e dhunës në familje të komunes së Istogut strehohen për një kohë të caktuar në këtë institucion .

-Fuqizimi dhe subvencionimi i familjeve strehuese – Aktualisht ne kemi 3 familje strehuese, këto familje strehojnë fëmijet e braktisur dhe janë familje me prioritet për komunën e Istogut të cilat i subvencionojmë dhe i përkahim në forma të ndryshme.

-Subvencionimi i nënave vetëushqyese – Nënata vetëushqyese në kushte të vështira ekonomike janë subvencionuar me nga 200 euro nga drejtoria e mirëqenies sociale

-Nënshkrimi i momerandum mirëkuptimit me oragnizatën Syri Vizion me qëllim të ndertimit të Komuniteteve miqësore për të moshuarit ndermjet veprimit nëpër breza në Kosovë dhe krijimi i hapsirave rekreative për të moshuarit- Përmes këtij projekti synojmë të krijojmë një qender ditore për grupmoshen e tretë duke aktivizuar këtë kategori përmes aktiveteve të ndryshme që parashohim gjatë ketyre viteve

-Aktivitete me rezidentet e shtëpisë së komuniteteve në Gurrakoc – shetitje periodike me shenimin e festave kalendarike .

-Hartimi i Rregullores për organizimin e brendshëm të punës në shtëpinë e personave të moshuar dhe pa përkujdesje familjare

-Ofrimi i shërbimeve shtesë për personat e moshuar në bashkëpunim me kolegjin Heimerer: Jemi në fazën fillimtare të vlerësimit të gjendjes shëndetësore të rezidentëve, dhe më pas do të ofrohen shërbime logopedike, fizioterapike, dhe neuropsikiatrike.

-Inspektimi javor i shtëpisë së Komuniteteve në Gurrakoc, Me anë të inspektimeve javore synojmë përmirësimin e jetës dhe krijimin e kushteve më të favorshme për rezidentet në shtëpinë e komuniteteve në Gurrakoc.

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE
RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2023

Në kuadër të Drejtoratit për Shërbime Publike, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 nga ana e palëve gjegjësisht nga qytetarët na janë parashtruar gjithsejtë 964 kërkesa nga ato kërkesa janë :

- Të miratuara 570
- Të refuzuara 1960
- Anuluar 8
- Në Proces 190

Në kuadër të Drejtoratit për Shërbime Publike, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 nga ana e palëve gjegjësisht nga qytetarët na janë parashtruar kërkesa të ndryshme:

Kërkesat e parashtruara nga palët, gjegjësisht qytetarët janë të natyrave të ndryshme dhe atë për:

Licencë Auto-Taxi,

Kërkesa për furnizim me gypa të ujësjellësit dhe kanalizimit,

Kërkesa për furnizim me material ndërtimor për raste emergjente,

Kërkesa nga lëmia e komunikacionit (transport , sinjalizim),

Kërkesa për furnizim me Zhavorr për rrugët lokale të pa asfaltuara ,

Kërkesë për prerje Asfalti,

Kërkesa për shpenzime të varrimit,

Kërkesa për strehim dhe ndihmë në ndërtimin e shtëpive, etj.

SEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE:

Gjatë kësaj periudhe bazuar në kërkesat e qytetareve kemi dalë në teren duke shqyrtuar dhe analizuar të gjitha rastet varësisht prej mundësive buxhetore ju kemi dalë në ndihmë duke u bazuar në kontratat e aktiviteteve të ndryshme të cilat përmbushin edhe kërkesat e qytetareve qofshin ato furnizim me zhavorr, furnizim me material ndërtimor, furnizim me gypa të ujësjellësit dhe kanalizimit etj. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe vjetore është përgatitur dokumentacioni me kohë për shpalljen të tenderëve të paraparë në planin buxhetor. Gjatë vitit 2023 DSHP ka hartuar planin komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027, po ashtu edhe rregulloren komunale për menaxhim të mbeturinave, gjithashtu është hartuar edhe plani strategjik për ujësjellës dhe kanalizim.

Në bashkëpunim Komuna e Istogut dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe GIZ komuna e Istogut është përfitues i projektit për përgatitjen e Planit Komunal për Energji të Qëndrueshme dhe Klime (PKEQK) ang. (SEQAP) .ky projekt është i përfshirë në konventën e Kryetareve të Komunave –Bashkive të Ballkanit Perëndimorë dhe Turqisë.

Ndërsa gjatë këtij viti nga planifikimi buxhetor për DSHP janë realizuar këto projekte:

LISTA E PROJEKTEVE KAPITALE TE REALIZUAR NGA DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2023
NDERTIMI I KANALIZIMEVE

1. Ndërtimi i kanalizimit në lagjen Balaj – Lluga, me gjatësi L= 1300m, në vlerë prej 20,000.00€,
2. Ndërtimi i kanalizimit të Burimi dhe pishat – Istog, me gjatësi L= 415m, në vlerë prej 10,000.00€,

3. Ndërtimi i kanalizimit në lagjen Maxharraj, Hasanaj – Prekallë, me gjatësi L= 600m, ne vlerë prej 10,000.00€,
4. Ndërtimi i kanalizimit në Lubozhdë faza e parë, me gjatësi L= 2200m, ne vlerë prej 25,000.00€,
5. Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Mojshtir, me gjatësi L= 2200m, ne vlerë prej 40,000.00€,
6. Ndërtimi i kanalizimit në lagjen Jahaj – Rakosh, me gjatësi L= 620m, ne vlerë prej 10,000.00€,
7. Ndërtimi i kanalizimit në Studenicë- lagja Zeqiraj dhe Lipaj, me gjatësi L= 1050m, ne vlerë prej 17,000.00€,
8. Ndërtimi i kanalizimit në Vrellë, lagjen Fetahaj, Rugovaj dhe Blakaj, me gjatësi L= 2835m, ne vlerë prej 35,000.00€,
9. Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Drejë, me gjatësi L= 750m, ne vlerë prej 20,000.00€,
10. Ndërtimi i kanalizimit në Orroberrdë, lagja Miranaj, Ukaj, me gjatësi L= 870m, ne vlerë prej 15,000.00€,
11. Ndërtimi i kanalizimit në Kosh, lagjen Frrokaj, me gjatësi L= 800m, ne vlerë prej 15,000.00€,
12. Ndërtimi i kanalizimit në Lubovë- Llukavc , me gjatësi L= 3000m, ne vlerë prej 60,000.00€,
13. Ndërtimi i kanalizimit në Prigodë, me gjatësi L= 1315m, ne vlerë prej 25,000.00€.

NDERTIMI I NDRIÇIMEVE PUBLIKE

1. Ndërtimi i Ndriçimit publik në Banjë, me gjatësi L= 1200m, ne vlerë prej 15,000.00€,
2. Ndërtimi i Ndriçimit publik në Zallq-Zabllaq, me gjatësi L= 1800m, ne vlerë prej 15,052.00€,
3. Ndërtimi i Ndriçimit publik në Vrellë, me gjatësi L= 3480m, ne vlerë prej 25,000.00€,
4. Ndërtimi i Ndriçimit publik në Istog të Poshtem, me gjatësi L= 4400m, ne vlerë prej 25,000.00€,
5. Ndërtimi i Ndriçimit publik në Gurrakoc, me gjatësi L= 4050m, ne vlerë prej 25,000.00€.

NDERTIMI I TROTUAREVE

1. Ndërtimi i trotuarit në Dubravë, me gjatësi L= 700m, ne vlerë prej 30,000.00€,
2. Ndërtimi i trotuarit Koder – Poligoni sportiv në Tomoc, me gjatësi L= 400m, ne vlerë prej 15,000.00€,
3. Ndërtimi i trotuarit në Shushicë e Epërme - shkolla, me gjatësi L= 330m, ne vlerë prej 15,000.00€,
4. Ndërtimi i trotuarit Lubovë-Banjë, me gjatësi L= 1000m, ne vlerë prej 35,000.00€,
5. Ndërtimi i trotuarit Baicë-Kashicë Saraderan, me gjatësi L= 1300m, ne vlerë prej 70,000.00€.

PROJEKTETE TE NATYRAVE TJERA

1. Rregullimi i infrastrukturës së varrezve Dubovë-Saraderan-Trubuhovc, ne vlerë prej 30,000.00€,
2. Ndërtimi i varrezave te reja në Vrellë-vazhdim projekti, ne vlerë prej 50,000.00€,
3. Ndërtimi i tregut të Ri në Istog, ne vlerë prej 175,000.00€,
4. Ndërtimi i transfer deponisë në Tuqep, ne vlerë prej 30,000.00€,
5. Ndërtimi i mureve mbrojtëse në territorin e komunës së Istogut (Shushicë e Epërme lagja Avdylaj, Mulaj, Cerrcë lagja Maxharraj, Studencë lagja Zeqiraj), ne vlerë prej 35,000.00€,
6. Ndërtimi i urave në territorin e komunës së Istogut, (Vrellë, Kovragë, Kaliqan,Gurarakoc), ne vlerë prej 55,000.00€,
7. Trasimi i rrugës Orroberrdë, Banjë, lagja Muzlijaj dhe trubuhovc lagja Osmanaj, ne vlerë prej 20,000.00€.

8. Ndërtimi i kanalit të ujitjes në Rr."Qazim Hakaj" në Vrellë, ne vlerë prej 10,000.00€,
9. Ndërtimi kanalit kullues lagja Ibrahimaj në Shushicë, ne vlerë prej 10,000.00€.

NGA KODI BUXHETOR MALLERA DHE SHERBIME, JANË REALIZUAR KETO PROJEKTE

1. Furnizimi me gypa për ujësjellës dhe kanalizimit, ne vlerë prej 31,000.00€,
2. Mirëmbajtja e ndriçimit publik, ne vlerë prej 35,000.00€,
3. Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale të asfaltuara, ne vlerë prej 42,795.00€,
4. Sinjalizimi horizontal dhe vertikal (rrugët lokale dhe qendrat urbane), ne vlerë prej 31,500.00€,
5. Eliminimi i mbeturinave nga hapësirat publike, ne vlerë prej 15,000.00€,
6. Mirëmbajtja e parkut të qytetit, ne vlerë prej 24,000.00€,
7. Rregullimi i pusetae, ne vlerë prej 15,000.00€,
8. Renovimi i stacionit të autobusëve në Istog, ne vlerë prej 7,000.00€,
9. Rregullimi i rrethojës së varrezave në Orroberdë lagja Miranaj dhe Lagja Tafilaj në Rakosh, ne vlerë prej 7,000.00€.

Në fund të vitit buxhetor 2023 është bërë edhe planifikimi i prokurimit për vitin vijues 2024.

ZYRA KOMUNALE PËR KOMITETE DHE KTHIM RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2023

HYRJJE

Zyra Komunale për Komitete dhe Kthim (në vazhdim do i referohemi si ZKKK), është përgjegjëse për rritjen mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve dhe për sigurinë e qasjes së drejtë të komunitetit në shërbimet publike në nivel komunal. Është pjesë integrale e Komunës dhe strukturës së përgjithshme administrative. Ka një nënzyrë, atë në fshatin **Cerkolez**.

Që nga fillimi, ZKKK ka qenë e inkuadruar në procesin e përmirësimit të marrëdhënieve ndëretnike dhe formimit të klimës së duhur për riintegrim të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Komunën e Istogut.

PËRMBLEDHJE

Gjatë peridhës së lartëcekur, ZKKK-ja në Komunën e Istogut ka pranuar gjithsej 100 lëndë. Kemi realizuar vizita në terren, kemi pasur takime me organizta të huaja dhe vendore lidhur me realizimin e projekteve që ka ZKKK-ja.

Në kuadër të punëve të rregullta, ZKKK kryen edhe punë të tjera si në vijim:

- Angazhohet për integrimin e të gjitha komuniteteve në komunë tonë, duke iniciuar çështjen e bashkëjetesës së komuniteteve pakicë me atë shumicë;
- Merr pjesë në mbledhjet e Komiteteve, si: Komitetin për Komitete, dhe në këtë Komitetë kontribonë dhe mbronë interesat e të gjitha komuniteteve të cilat jetojnë dhe punojnë në Komunën e Istogut.

- Bashkëpunon me Ministrin për Komunitete dhe Kthim me qëllim të realizimit të shumë projekteve në të mirë të të gjitha bashkësive minoritare etnike dhe bashkësive të tjera;
- Viziton familjet të cilat janë kthyer nga shtetet fqinje dhe vendet tjera, me qëllim që të njihet me problemet e tyre në të cilat ata hasin dhe integrimin e tyre në shoqërinë Kosovare. Gjithashtu viziton edhe familjet që ende gjenden në hapësirat e shteteve fqinje, ku bisedon me ata persona të shpërngulur dhe njëkohësisht i njofton me mundësinë e kthimit dhe mënyrën si mund të kthehen ata.
- Bashkëpunon me organizatat joqeveritare të cilat merren me kthimin e personave të kthyer siç janë: UNHCR, IOM, USAID, MercyCorps, OSCE, DRC etj.

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA (Në kuadër të Planit të Punës së ZKKK-së)

ZKKK-ja, duke u bazuar në kompetencat e saj, ka planin e punës, në të cilin përfshihen planifiket për aktivitet të cilat presin që të realizohen gjatë vitit. Planifikonë dhe menaxhon me të gjitha kodet buxhetore, me përjashtime të shpenzimeve komunale. Me poshtë i gjeni të listuara aktivitetet e planifikuara:

- Ndertimi i rruges ne lagjen Delijaj dhe Freokaj ne Kosh
- Ndertimi i Kanalizimit ne Banje , Lagja Ramic dhe Durovic
- Ndertimi i Kanalizimit ne Dobrush te Tuzi
- Ndertimi i rruges Verbica ne Crkolez
- Asfaltimi i rrugës “Sarajeva , Dobrushë

AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

- Ndertimi i rruges ne lagjen Delijaj dhe Freokaj ne Kosh
- Ndertimi i Kanalizimit ne Banje , Lagja Ramic dhe Durovic
- Ndertimi i Kanalizimit ne Dobrush te Tuzi
- Ndertimii rruges Verbica ne Crkolez
- Asfaltimi i rrugës “Sarajeva , Dobrushë -dyvjecar

AKTIVITETET NË BASHKËPUNIM ME OJQ

- Renovimi i dy shtëpive të 2 familjeve të komunitetit Serb, njëra në Cerkolet dhe njëra në Dragolec, në bashkëpunim me IOM.
- Ndërtimi i shtëpive për 11 familje: 10 për komunitetin Serb dhe 1 për komunitetin Egjiptian.

PROCESI I RIATDHESIMIT

Të riatdhesuar sipas SMR

- Sipas Sistemit të Mënaxhimit të Rasteve, kemi 2 familje me 7 persona, si dhe 3 persona të cilët janë riatdhesuar si individ.

- Prej të lartëcekurve kemi 3 familje në skemën e Akomodimit me Qira në kuadër të Programit për Riintegrim të Peronave të Riadhesuar.

Kërkesa të parashtruara pranë ZKKK-së

- Kemi gjithsej 7 kërkesa të parashtruara pranë ZKKK-së për ndihmë në Programi, të cilat KKR-ja i ka shqyrtuar dhe ka vendosur si në vijim:
 - 3 kërkesa për Akomodim me qira, të aprovuara nga KKR-ja,
 - 1 kërkesa për Pako dimërore, prej tyre 3 të rekomanduara, 1 në pritje për shqyrtim nga KKR,
 - 1 kërkesa për Trajtim Mjekësor (Medikamente), në pritje për shqyrtim nga KKR,
 - 1 kërkesë për Renovim, në pritje të kompletimit të dokumentacionit nga pala e riatdhesuar, në mënyrë që të shqyrtohet nga KKR,
 - 1 kërkesë për Orendi Shtëpiake, në pritje të kompletimit të dokumentacionit nga pala e riatdhesuar, në mënyrë që të shqyrtohet nga KKR.

Komuna Istog
Datë:

Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI